

UNITED NATIONS
United Nations
Interim
Administration
Mission in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

KUVENDI I KOSOVËS СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

BULETINI

Korrik, 2006 Nr.13



Gjatë bisedave me njerëzit në Kosovë dhe shëtitjes në 24 orët e fundit, kam mundur ta vërej diellin duke lindur. Do të jetë një agim i mrekullueshëm. Pas njëzet viteve të vështira, ose treqind e më shumë viteve të vështira, kjo do të jetë një arritje e madhe. Do të jetë arsye e madhe për t'u festuar. Do të hapë një kapitull të ri në historinë tuaj (Klark)

Vlerësohet puna e Kuvendit për përmbushjen e standardeve

Të përfundojë puna lidhur me krijimin e Komisionit të Pavarur për Media Kuvendi të procedojë sa më shpejt për zgjedhjen e Ombudspersonit të Kosovës OSBE-ja do të vazhdojë të mbështesë bashkëpunimin legjislativ të Kosovës me parlamentet e Evropës dhe të rajonit



Shefi i OSBE-së në Kosovë, ambasadori Verner Wnendt, në takim me kryeparlamentarin Berisha, ka çmuar lart punën e Kuvendit të Kosovës në përmbushjen e standardeve, kurse seancën e sotme plenare e ka vlerësuar shumë të suksesshme. Në këtë takim të rregullt të komunikimit të ndërsjellë është folur edhe për disa projekte që duhet të përfundojnë dhe të tjera që duhet të fillojnë të realizohen.

Në këtë vështrim është thënë se duhet të përfundojë puna lidhur me krijimin e Komisionit të Pavarur për Media (zgjedhje e anëtarit të pestë), si dhe çështja e procedimit sa më shpejt nga Kuvendi për zgjedhjen e Ombudspersonit të Kosovës.

Kryeparlamentari Berisha e ka vlerësuar mbështetjen e OSBE-së për deputetët dhe stafin e Kuvendit, kurse ambasadori Wnendt ka premtuar se OSBE-ja do të vazhdojë ta mbështesë bashkëpunimin legjislativ të Kosovës me parlamentet e Evropës dhe të rajonit.



PËRMBAJTTJA:

Greqia është e interesuar që aktivitetet e deritashme në Kosovë t'i intensifikojë edhe më 6

Duhet të shtohet veprimi i institucioneve për funksionimin e sundimit të ligjit 8

Kombi shqiptar po ecën i lirë, Shqipëria dhe Kosova si dy motra po ecin drejt integritimeve evropatlantike 9

Model brilant i veprimit dhe i reagimit të politikanit të matur e të vendosur 13

Shumë halle e kërkesa, pak mjete 19

Redaksia:

Sherif Konjufca, Shefqet Rexhepi, Celal Ilyas, Edona Fetahu

Telefonat Kontaktues:

038\ 211 186, 038\ 211 949, 038\ 211 189, 044\ 127 921

Tel/Fax: **038 211 188**

E-mail:

media@assembly-kosova.org

Web faqja:

www.assembly-kosova.org

Kosova do të bëhet, ashtu siç duhet të jetë, shtet i pavarur

Gjatë bisedave me njerëzit në Kosovë dhe shëtitjes në 24 orët e fundit, kam mundur ta vërej diellin duke lindur. Do të jetë një agim i mrekullueshëm. Pas njëzet viteve të vështira, ose treqind e më shumë viteve të vështira, kjo do të jetë një arritje e madhe. Do të jetë arsye e madhe për t'u festuar. Do të hapë një kapitull të ri në historinë tuaj, theksoi gjenerali Klark

Kuvendi i Kosovës, kryesuar nga Kolë Berisha, kryetar, mbajti sot një seancë solemne. Në këtë seancë me një fjalë rasti deputetëve iu drejtua, gjenerali i njohur amerikan, tash në pension, miku i madh i Kosovës, Uesli Klark. Duke hapur këtë seancë, kryeparlamentari Berisha iu drejtua të pranishmëve me këto fjalë:”

*I nderuari President Sejdiu,
I nderuari Përfaqësues i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, z. Petersen,
Kolegë të nderuar deputetë,
Të nderuar anëtarë të Kabinetit Qeveritar,
Zonja dhe zotërinj,*

Kam kënaqësinë, nderin dhe privilegjin e veçantë që sot, para Jush, në cilësinë e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, t’ua prezantoj dhe, natyrisht, pas pak minutash, t’ia jap fjalën, njeriut, i cili, shtatë vjet më parë, duke u vënë në ballë të Fuqisë më të madhe të botës – Aleancës Veriatlantike - e shpëtoi nga shfarosja totale një popull të tërë, racën më të vjetër në Ballkan dhe njërën ndër më të vjetrat në Evropë; e shpëtoi nga përmbytja, pothuajse, apokaliptike, ku e shtynte me dhunë makineria ushtarako-policore dhe paramilitare e regjimit më famëkeq në historinë e njerëzimit, dhe ia mundësoi kthimin e sërishëm dhe të sigurt, përmes një ringjalljeje, pothuajse biblike.

Ta prezantoj para Jush, dhe ta ftoj për të paraqitur fjalën përshëndetëse, njeriun i cili, bashkë me presidentin Klinton, me Sekretaren e Shtetit, znj. Medllin Ollbrajt dhe me shumë të tjerë që e përkrahen dhe e ndihmuan, jo vetëm në



vendimmarrje, por edhe në ekzekutim, e respektoi dhe realizoi me përpikëri, edhe të ashtuquajturin “Kërcënim i kërsëndellave”, të Bushit të vjetër.

Dhe, më në fund, kam kënaqësinë, nderin dhe privilegjin e veçantë që ta prezantoj para Jush, njeriun, emri i të cilit, jo vetëm që tashmë është i njohur dhe shqiptohet me respekt e pietet të lartë, por që hyri fuqishëm në mënyrën më meritore në historinë më të re të Kosovës. Njeriun i cili pati vizion, kurajo dhe vendosmëri për të marrë veprime të mëdha, veprime nga ato që stampohen fort në histori dhe nuk harrohen kurrë nga brezat.

Të nderuar të pranishëm, Gëte thotë: “Mik, kohërat e arta kanë kaluar, por njerëzit e mirë i kthejnë sërish ato”.

Duke i thënë edhe njëherë faleminderit për të gjitha ato që ka bërë për Kosovën, ftoj njërin ndër ata njerëzit e mirë të cilët ia kthyen Kosovës këto kohë të arta – kohën e lirisë dhe të pavarësisë, ftoj Gjeneralin e madh, Uesli Klark që ta marrë fjalën”!

Ky është agimi i një epoke të re

Duke u falënderuar për këtë pritje të ngrohtë Gjenerali Uesli Klark iu drejtua të pranishmëve me këto fjalë: “Zotëri kryetar, faleminderit shumë për ato fjalë të mira. Zotëri kryetar, kryeministër Çeku, deputetë të Kuvendit dhe miq. Jam shumë i lumtur që sot jam me ju këtu. Është nder shumë i madh për mua, dhe i pranoj fjalët e thëna si mirënjohje edhe në emër të gjithë neve, të cilët punuam, luftuam, dhe shpresuam për këtë ditë e cila po u vjen. Atë që pata mundësi ta bëj këtu, nuk e bëra vetëm, dhe më duhet të pranoj këtë. Ishte lidhësi i kryetarit Klinton dhe Sekretarja e Shtetit, Medlin Ollbrajt, kryeministri Toni Blair, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Javier Solana, dhe të gjitha shtetet anëtare të NATO-s dhe kolegët e mi oficerë nga forcat e armatosura, Kongresi ynë dhe shumë e shumë të tjerë, të cilët e panë padrejtësinë që po ndodhte këtu dhe të cilët donin ta kthenin drejtësinë, t’i ndihmonin popullit të Kosovës dhe t’i ndihmonin Evropës të ecë përpara. Kështu që sot po u

sjell përshëndetjet dhe urimet më të mira nga miqtë tuaj të shumtë nga Shtetet e Bashkuara, dhe natyrisht, edhe nga shumë anëtarë të diasporës nga Shqipëria dhe Kosova, të cilët i kam takuar në udhëtimet e mia në mbarë Amerikën. Veçanërisht jam mirënjohës për ftesën që kam marrë nga miku im Çeku që të vijë këtu. Kjo është hera e parë që po kthehem në Kosovë, që kur e kam hequr uniformën dhe janë bërë më shumë se gjashtë vjet që kur isha këtu herën e fundit. Është kënaqësi e madhe që po ju shoh prapë të gjithëve, por veçanërisht Juve, zotëri kryeministër. Unë pata rastin ta njoh Kryeministrin tuaj kur ai po e udhëhiqte UÇK-në dhe kur ne po e krijonim konceptin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës. Fillova ta kuptoj se ai ishte një burrë shumë i veçantë. Natyrisht, ai ishte burrë ushtarak, i rritur këtu, por që kishte shërbyer në Ushtrinë Jugosllave. Më vonë kishte shërbyer edhe në Ushtrinë e Kroacisë, dhe kishte marrë pjesë në operacionet e ushtrisë kroate në vitin 1995, para se të kthehej këtu. Ishte burrë me njohuri të gjëra, por ishte më shumë se një burrë ushtarak. Ishte një njeri që zgjidhte probleme; një njeri që në mënyrë të qetë dhe me arsye merrej me çështjet. Ai ishte figura kyçe, e cila na ndihmoi që të tejkalojmë ca vështirësi, për të cilat disa mendonin se ishin problemi kryesor i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Na ndihmoi që të krijojmë një organizatë shumë të dobishme dhe produktive. Të uroj pra Agim për lidhshimin tënd dhe të uroj për pozitën tënde këtu, sepse mendoj se talentet tuaja mund t'i realizosh këtu në Qeveri dhe në punën e rëndësishme që e keni përpara. Mendoj se ky është agimi i një epoke të re, dhe gjatë bisedave me njerëzit në Kosovë dhe shetitjes në 24 orët e fundit, kam mundur ta vërej diellin duke lindur. Do të jetë një agim i mrekullueshëm. Pas njëzet viteve të vështira, ose treqind e më shumë viteve të vështira, kjo do të jetë një arritje e madhe. Do të jetë

arsye e madhe për t'u festuar. Do të hapë një kapitull të ri në historinë tuaj. Do të kërkohet shumë punë, përkushtim dhe sakrificë në ditët që vijnë, por e ardhmja, me të vërtetë është në duart e juaja. Ju do t'i krijoni idetë, besimin, dhe institucionet të cilat me të vërtetë do të krijojnë bazën për përparim në Kosovë. Qëllimin të cilin e synoni është të ndërtoni një shtet demokratik, stabil, dhe të begatshëm, i cili do t'i ofrojë secilit qytetar, të cilin do komunitet, mundësinë të jetojë në paqe dhe dinjitet, dhe të bëhet anëtar i komunitetit euro-atlantik. Dua t'u ofrojë përkrahjen time të plotë personale përdërisa ju e synoni këtë qëllim, dhe jam i bindur që ju do ta realizoni atë. Jam i bindur që procesi në të cilin gjendeni tani për zgjidhjen e çështjes së statusit final, do të përfundojë dhe jam i bindur që në fund të këtij procesi, Kosova do të bëhet, ashtu siç duhet të jetë, shtet i pavarur.

Standardet janë ato që do ta bëjnë Kosovën stabile, të sigurt, demokratike dhe të begatshme

Ju e keni dëgjuar bashkësinë ndërkombëtare të thotë disa herë se duhet të përmbushen disa standarde para se të zgjidhet çështja e statusit të Kosovës, por unë do ta thojë në një mënyrë tjetër, që standardet janë ato që do ta bëjnë Kosovën stabile, të sigurt, demokratike, dhe të begatshme. Këto standarde do ta bëjnë Kosovën asi lloj shteti modern, për të cilin Ibrahim Rugova, Adem Jashari, dhe shumë të tjerë luftuan dhe dhanë jetën e tyre. Kështu që, ndërtimi i kësaj shoqërie dhe përmbushja e këtyre standardeve nuk bëhet për t'u dorëzuar para presionit nga jashtë apo për t'i kënaqur të huajt. Në fakt, është e kundërta. Është veprimi i duhur për ju, për fëmijët tuaj dhe për gjeneratat e ardhshme. Për këtë arsye mendoj se ju mund ta kuptoni se kjo e ardhme është në duart tuaja dhe ju do t'i realizoni këto.

Edhe ju do ta tejkaloni dhembjen

Kur në vendin tim luftonim për pavarësi kundër Britanisë, ne patëm dy mundësi para nesh: të mbajmë inat dhe ndjenja hakmarrjeje ndaj monarkisë Britanike, ose të ecim përpara dhe t'i inkorporojmë e të punojmë me ata që më herët nuk pajtoheshin me ne. Në atë rast ne u përcaktuam për variantin e dytë. Nuk ishte e lehtë, kishim njerëz që ishin përndjekur edhe abuzuar gjatë luftës së revolucionit amerikan. Por si komb, Amerika kapërceu atë moment dhe mendoj se edhe ju do ta tejkaloni dhembjen dhe mundimin drejt caktimit për gjetjen e një të ardhme më të ndritshme. Kjo gjë kërkon vendime të vështira madje edhe ndryshime në të gjitha nivelet e shoqërisë, sepse nga mazhoranca kërkohet që të drejtat e pakicave të respektohen plotësisht nga të gjithë, që të sundojë ligji dhe që qeveria të shërbejë në interes të të gjithë qytetareve të saj. Këtë mëngjes unë u takova me ekipin e unitetit dhe jam i bindur se udhëheqësit tuaj janë të përkushtuar që këto synime t'i realizojnë në praktikë. Por këto synime të shumicës në Kosovë duhet të pranohen edhe nga pakicat në Kosovë. Realiteti i demokracisë është që pakicat të respektojnë vullnetin e shumicës dhe që pakicat të jetojnë sikurse shumica në bazë të sundimit të ligjit, dhe pakicat ashtu sikurse edhe shumica duhet të marrin pjesë në institucionet e vendit. Natyrisht që mund të ketë marrëdhënie shoqërore apo vëllazërore me vendet fqinje të bazuara në lidhje etnike apo fetare, por nuk mund të ketë autoritete shtetërore paralele të kontrolluara nga jashtë Kosovës. Mendoj, që nëse i shikoni vendet e rajonit mund të gjeni shembuj se si krijohen lidhjet me ato jashtë kufirit pa ndërhyrje, apo ndikim të panevojshëm nga atje. Fundi i fundit ajo që mund të jetë e drejt për serbët në Kosovë mund të jetë e drejtë për shqiptarët në Serbi. Propozimet për decentralizim, që Qeveria të jetë më

afër popullit, të cilat unë i kam parë, më duken si qasje e shëndoshë dhe diçka të cilën ju mund ta ndërtoni për ta bërë shtetin tuaj më të fortë dhe më të begatshëm. Do të ballafaqoheni me sfidat e krijimit të marrëdhënieve me shtetet e tjera të rajonit, sepse nuk mund të ketë të ardhme të sigurt dhe prosperuese për Kosovën nëse rajoni do të jetë jostabil dhe i varfër. Të jemi të sinqertë, marrëdhëniet e ardhshme me Serbinë do të jenë më të vështira. Kjo gjë do të kërkojë shumë durim dhe disiplinë për të tejkaluar frikën, pasigurinë dhe historinë e së kaluarës. Qytetarët dhe udhëheqësit e Serbisë kanë përgjegjësi edhe më të madhe për t'u ballafaquar dhe për të lënë prapa të kaluarën e tyre shkatërrimtare, por do të kenë nevojë për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj për të arritur atë qëllim. BE-ja dhe NATO-ja kanë përvojë të konsiderueshme për të ndihmuar qeveritë, që të tejkalojnë rivalitetet dhe mungesën e besimit të së kaluarës. E di që BE-ja dhe NATO-ja po përpiqen të ndihmojnë shtetet e Ballkanit për të tejkaluar ndasitë e hidhura historike të rajonit. Por të gjithë ne nuk mund të ecim përpara në ardhmëri nëse nuk jemi në gjendje të shikojmë përtej së kaluarës. Ne, në SHBA, gjithnjë themi me shaka se amerikanët nuk e kujtojnë historinë e tyre, por kur të vijnë në Evropë shihet sa shumë ruhet kujtimi i së kaluarës historike. Disi duhet ta gjejnë mesin më të mirë të të dy këtyre botërave, sepse kjo është një kohë në Kosovë, kur duhet të mendoni për të ardhmen; një të ardhme përtej kohës së pasigurive, (është fjala për sigurinë fizike), një e ardhme përtej kohës kur ushtritë kalonin kufijtë e njëri tjetrit. E di se kjo gjë ka ndodhur në një të kaluar jo të largët dhe e di se ka pasur dhembje e tragjedi. Por ju jeni nisur drejt një të ardhme të re, e ardhme që do të definohet nga ekonomia juaj, kur njerëzit në këtë vend, në këtë shtet të pavarur, do të mund të ndërtojnë afarizëm të suksesshëm, që mund të tërheqin investime të huaja, që të bindin rininë për

të studiuar me zell, të arrijnë shumë dhe të realizojnë ëndrrat për prosperitet dhe të gjitha këto janë të mundshme. Unë kam udhëtuar nëpër botë ashtu sikurse dhe shumica prej jush dhe kam parë shoqëri në të cilat rinia mund t'i realizoj këto ëndrra duke u përgatitur, punuar dhe studiuar. I kam parë shoqëritë në të cilat investitorët nga jashtë janë bindur që të sjellin me qindra miliona dollar dhe të eksploatojnë burimet natyrore, talentet dhe institucionet, dhe e gjithë kjo është e mundur edhe këtu. Ju mund ta ndërtoni këtë ekonomi të madhe, të jepni shpresë dhe begati, një ndjenjë për punë dhe të ardhme të ndritshme për çdo qytetar. Të gjitha këto janë të mundshme.

Udhëheqësit kanë përgjegjësi, por përgjegjësi kanë edhe qytetarët e zakonshëm

Besoj që në afat të shkurtë do të vazhdoni të punoni me misionin e OKB-së në Kosovë, dhe do të vazhdoni të themeloni një kornizë të mirë të politikave ekonomike. Por shumë shpejt duhet të shikoni përtej mbështetjes së institucioneve qeveritare dhe ndërqeveritare ndërkombëtare dhe të punoni me investitorë privatë. Ata që i duan investitorët privatë, dhe pasi që tani nuk jam më në uniform, jam një nga këta të komunitetit afarist, janë rregulla të qarta dhe të drejta të lojës. Kështu që ju inkurajoj të punoni shumë në krijimin e një ambienti të mirë afarist, të tërhiqni investitorë të huaj, t'iu tregojmë talentin dhe energjinë e popullit të kësaj pjese të mirë të Evropës. Dhe mbi të gjitha të themelohet një ambient i sinqeritetit, integritetit dhe i qeverisjes ku njerëzit nga vendet e largëta do të jenë të sigurt se nëse investojnë parat e tyre këtu do të jenë të sigurt dhe profitabile. Ky është çelësi i zhvillimit ekonomik dhe i një të ardhme të ndritshme.

Në përfundim më lejoni t'i them disa fjalë lidhur me përgjegjësinë qytetare. Natyrisht që udhëheqësit kanë përgjegjësi, por përgjegjësi kanë edhe qytetarët e zakonshëm.

Gjatë të kaluarës nën sundimin e Beogradit ishte e kuptueshme që institucionet qeveritare dhe ligjet janë parë si instrumente të shtypjes, të cilat duhej shmangur ose injoruar. Këtë e kam parë në mbarë rajonin e Ballkanit. Një nga tiparet më të shëmtuara të regjimit të Milosheviqit ka qenë kontrabanda, mospagesa e tatimeve dhe e shërbimeve publike. Kjo gjë ishte dukuri endemike e tërë rajonit. Disa njerëz këtë e shikonin si mosbindje e ligjshme qytetare dhe si rezistencë ndaj dominimit të jashtëm. Por ajo kohë ka kaluar dhe tani Qeveria e Kosovës është populli i Kosovës, dhe çdo qytetar duhet të pranojë pjesën e vet të përgjegjësisë për të përkrahur Qeverinë, për të paguar tatimet, faturat e tyre dhe të bashkëpunojnë me forcat e rendit edhe kjo është karakteristikë e një shoqërie të suksesshme. Me forcimin e këtij bashkëpunimi, në Kosovë do të ketë më shumë mundësi për rritje ekonomike, zhvillim dhe vende të punës. Kështu që më lejoni në përfundim të shpreh edhe njëherë mirënjohjen për rastin që të vij këtu, dhe faleminderit Agim personalisht për këtë. Nuk mund t'iu them se sa domethënie ka kjo për mua që të kthehem pas gjashtë viteve dhe të shohë këtë vend plot prosperitet dhe shpresë, në prag të agut madhështor, me mundësi të mëdha për popullin e tij. Dhe më lejoni t'ju inkurajoj që të shkoni në të ardhmen me optimizëm, vizion, zemërgjerësi dhe shpresë, sepse prej jush varet e ardhmja e Kosovës. Me kurajën dhe përkushtimin që kam parë tek njerëzit e këtij vendi, të pafundme janë mundësitë për suksese, nëse punoni së bashku.

Ju faleminderit shumë për këtë nder të madh që më bëni dhe ju uroj fat"! Duke falënderuar Gjeneralin Klark për këtë fjalë të ngrohtë, në përmbyllje të kësaj seance solemne, kryeparlamentari Berisha tha: "Për Kosovën dhe në Kosovë ju do të mbeteni gjithmonë një gjeneral i madh".

Parlamentarët rusë e vlerësojnë gabim të madh abstenimin e deputetëve serbë në seancat e Kuvendit të Kosovës

*Shqiptarët dhe serbët të gjejnë mundësi për jetë të përbashkët në Kosovë
Kosova e së ardhshmes të jetë entitet i balancit dhe i paqes
Kreu i legjislativit të vendit pohon se në Kosovën e pavarur do të garantohen të drejtat
qytetare të të gjitha komuniteteve*



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, ka pritur sot një delegacion të Dumës Ruse, të kryesuar nga Sergej Baburin, zëvendëskryetar i parlamentit, me të cilin ka biseduar për punën e Kuvendit dhe perspektivat zhvillimore të të gjitha komu-

niteteve në Kosovën e së nesërme. Kryeparlamentari Berisha, fillimisht, mysafirëve rus u ka prezantuar strukturën dhe organizimin e Kuvendit të Kosovës, për të tu përqendruar pastaj në reformat në Parlament dhe aktivitetet ligjvënëse. Ai, ndërkaq, ka folur

edhe për përpjekjet për t'i kthyer deputetët serbë edhe në seancat plenare të Kuvendit të Kosovës.

Duke përvijuar vizionin për ardhmërinë e Kosovës, Berisha ka theksuar vendosmërinë e institucioneve dhe të qytetarëve të Kosovës për pavarësinë e vendit. Në këtë vështrim, ai ka theksuar se në Kosovën e pavarur do të garantohen të drejtat qytetare të të gjitha komuniteteve. Berisha, madje, ka pohuar se për hir të ardhmërisë së fëmijëve të Kosovës do të lihet anash historia e kalvareve tona.

Nënkryetari i Dumës Ruse, Sergej Baburin ka thënë se parlamentarët rusë e vlerësojnë gabim të madh abstenimin e deputetëve serbë në seancat e kuvendit të Kosovës. Ai ka shprehur qëndrimin e Parlamentit të Rusisë se Kosova e së ardhshmes duhet të jetë entitet i balancit të paqes dhe të stabilitetit, si dhe qëndrimin që shqiptarët dhe serbët duhet të gjejnë mundësi për jetë të përbashkët në Kosovë.

Greqia është e interesuar që aktivitetet e deritashme në Kosovë t'i intensifikojë edhe më

Konferenca e Selanikut është dëshmi e përcaktimit të Kosovës për zgjidhje të çështjes së minoriteteve sipas standardeve më të avancuara

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, në kuadër të qëndrimit në Selanik të Greqisë, ku mbajti fjalën e hapjes në konferencën kushtuar çështjes së komuniteteve në Kosovë, zhvilloi një takim me anëtarin e kabinetit të Qeverisë së Greqisë, ministrin Jorgos Kalanxis. Ministri Kalanxis është i ngarkuar në dikasterin për Maqedoni dhe Thraki me seli në Selanik. Takimi u mbajt me iniciativën e Qeverisë Greke.

Në këtë takim përveç stafit të bashkëpunëtorëve të kryeparlamentarit Berisha mori pjesë edhe shefi i Zyrës Greke në Prishtinë, Nikolas Kanelos. Të dy bashkëbiseduesit në këtë takim vlerësuan lart rëndësinë e temës së konferencës që po mbahet në Selanik, si dëshmi e përcaktimit të Kosovës për zgjidhje të çështjes së minoriteteve sipas standardeve më të avancuara. Kryetari i Kuvendit Berisha prezantoi zhvillimet e tjera aktuale në Kosovë dhe foli për

rëndësinë që ka njohja e pavarësisë së Kosovës si mundësi e avancuar e garantimit të pozitës së minoriteteve, por edhe për bashkëpunim të gjithanshëm e stabilitet në rajon. U bisedua edhe për forma konkrete të bashkëpunimit ndërparlamentar rajonal, ndërsa ministri Kalnaxic theksoi se Greqia është e interesuar që aktivitetet e deritashme në Kosovë t'i intensifikojë edhe më shumë me prani edhe më të madhe në aspektin e bashkëpunimit ekonomik.

E ardhmja e Kosovës është në duart e kosovarëve

Ditët e vizitës zyrtare të kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, me bashkëpunëtorë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin me agjendë shumë të ngjeshur të takimeve që u zhvilluan në Uashington dhe në Nju- Jork.

Kryeparlamentari Berisha u prit në Stejt Departamentin Amerikan nga zëvendësasistentja e sekretares në Departamentin e Shtetit për çështje të Evropës dhe të Euroazisë, Rozmari Di Karlo, pastaj u takua me Bertram Braunin, drejtor për Evropën Juglindore në Këshillin e Lartë të Sigurisë Kombëtare, me zonjën Laurie Dundon, shefe e Zyrës së zonjës Medlin Ollbrajt, me zotin Xhejms O'Brajen po nga Zyra e zonjës Ollbrajt, ndërsa në orët e pasdites ai mori pjesë në një tryezë të rumbullakët, të organizuar nga Departamenti i Shtetit, moderator i të cilës ishte Çarlls English, drejtor i Zyrës për Çështje të Evropës Jugore dhe Qendrore, e në të cilën morën pjesë dhe shtruan pyetje për delegacionin e Kosovës 10 përfaqësues të sektorëve të ndryshëm të Departmentit të Shtetit.

Prania ndërkombëtare edhe pas zgjidhjes së statusit

Në takimin me zonjën Di Karlo, kryeparlamentari Berisha e informoi atë për gjendjen aktuale në Kosovë, për procesin e negociatave të Vjenës, për ndryshimet që janë bërë në institucionet e Kosovës, për hapjen demokratike të Kuvendit të Kosovës, por vëmendje e posaçme në bisedë iu kushtua edhe Kosovës së pas statusit, prandaj kryeparlamentari Berisha kërkoi prani ndërkombëtare ushtarake dhe civile në Kosovë, sidomos amerikane, edhe pas zgjidhjes së statusit final

të Kosovës.

Kryeparlamentari Berisha e falënderoi zonjën Di Karlo për të gjitha ato që ka bërë e që po bën Qeveria Amerikane për Kosovën dhe e siguroi atë se Kosova e pavarur do të jetë faktor stabiliteti në rajon e më gjerë.

Zonja Di Karlo, pasi tha se është e njoftuar mirë me situatën në Kosovë, porositi që e ardhmja e Kosovës është në duart e kosovarëve. Jemi të kënaqur me punën e Ekipit Negociator të Kosovës dhe ju duhet të vazhdoni negociatat, tha ajo, me përkushtimin dhe me seriozitetin e treguar deri më tash. Duhet ta inkurajoni më tej kthimin e serbëve në institucione. Është test shumë i rëndësishëm për kosovarët sundimi i ligjit dhe kthimi i pronave të uzurpuara të të zhvendosurve nga Kosova dhe këtu mund të luajë rol shumë të madh edhe Parlamenti i Kosovës. Amerika, tha zonja Di Karlo, do të jetë e pranishme në Kosovë dhe në rajon edhe pas definimit të statusit të Kosovës. Në Kosovë do të ketë prani ushtarake e civile ndërkombëtare, tha ajo.

Në takimin me kongresistin Eliot Engëll, kryeparlamentari Berisha e informoi atë për zhvillimet më të reja në Kosovë, në frymë të negociatave për statusin final të Kosovës dhe për punën e Kuvendit të Kosovës të këtyre dy muajve të fundit. Kryetari Kolë Berisha u informua nga zoti Engëll për aktivitetet e tij më të fundit lidhur me zhvillimet rreth definimit të statusit të Kosovës.

Të krijohet atmosferë e demokracisë dhe e ripërtëritjes

Gjatë vizitës së kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha,

me bashkëpunëtorë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ai, u takua në Nju-Jork me ambasadorin amerikan Frenk Uizner, i dërguar i posaçëm amerikan në procesin negociator për Kosovën.

Në drekën e punës, të organizuar nga ambasadori Uizner, drekë kjo që zgjati mbi dy orë, kryeparlamentari Berisha e informoi ambasadorin Uizner për zhvillimet e deritanishme të negociatave në Vjenë, për angazhimin konstruktiv dhe për ofertën e palës kosovare në këto negociata, si dhe për zhvillimin e mëtejshëm të negociatave të ndërmjetësuara nga Marti Ahtisari, tha Uizner.

Konstruktiviteti i palës kosovare në negociatat e Vjenës, i demonstruar deri më tash, duhet të vazhdojë deri në fund, tha ai. Oferta e palës kosovare në këto negociata, e cila duhet të përmbajë fleksibilitet racional dhe të dobishëm, do të bëjë të mundur që zoti Ahtisari të ndërtojë qëndrimin e tij. Strukturat udhëheqëse të Kosovës: presidenti, kryeministri dhe ministrat, duhet të ndërmarrin hapa të mëtejshme që tregojnë se po shtrihet dora e ringjalljes së jetës së përbashkët ndërmjet të të gjitha komuniteteve. Le të ndihmohet më tej liria e lëvizjes së serbëve. Çështja kryesore është që të krijohet një atmosferë e re, një imazh i ri, që duhet t'i ofrohet botës, atmosferë e demokracisë dhe e ripërtëritjes së lirive të minoritarëve.

Dimensioni i tretë i angazhimit tuaj duhet të jetë vazhdimi i punës në përmbushjen e standardeve.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës gjatë kësaj vizite pati edhe një sërë takimesh me komunitetin shqiptar si dhe me shoqatat e tyre të Nju-Jorkut dhe të Detroitit.

Duhet të shtohet veprimi i institucioneve për funksionimin e sundimit të ligjit

Në ambientet e Kuvendit të Kosovës u mbajt takimi i 4-të (joformal) ndërparlamentar i delegacionit të Parlamentit të Evropës, të prirë nga zonja Doris Pack dhe delegacionit nga Parlamenti i Kosovës, i kryesuar nga kryeparlamentari Kolë Berisha. Në delegacionin e Parlamentit të Kosovës merrnin pjesë anëtarë të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, si dhe deputetë nga Grupi për Integrim, SLKM dhe grupi 6 +. Tema qendrore të takimit ishin situata politike në Kosovë dhe perspektivat për të ardhmen, me theks të veçantë negociatat që po zhvillohen lidhur me definimin e statusit të Kosovës, decentralizimi, prania e bashkësisë ndërkombëtare, progresi i shënuar në implementimin e standardeve, pozita e minoriteteve dhe funksionimi i institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes, si dhe gjendja ekonomike në Kosovë

Në mbyllje të takimit të katërt ndërmjet Parlamentit Evropian dhe delegacionit të Kuvendit të Kosovës, mbajtur në Prishtinë, më 21 qershor 2006, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, dhe kryesuesja e delegacionit nga Parlamenti Evropian, Doris Pak, dhanë këtë komunikatë të përbashkët: "Jemi të kënaqur me rezultatet e takimit të katërt, i cili mbahet



në një moment veçanërisht delikat të zhvillimit të bisedimeve për statusin e ardhshëm të Kosovës. Jemi thellësisht të bindur për domosdoshmërinë e vazhdimit dhe të intensifikimit të marrëdhënieve tona ndërparlamentare, të cilat duhet të jenë të rregullta gjatë viteve të ardhshme. Theksojmë që është me rëndësi të veçantë komunikimi dhe bashkëpunimi intensiv ndërparlamentar, në mënyrë të veçantë ndërmjet Parlamentit Evropian dhe Parlamentit të Kosovës.

Ne e vlerësojmë pjekurinë e treguar pas vdekjes së ish-Presidentit Rugova dhe zëvendësimit të tij, dhe vazhdojmë të shprehim nevojën e rritjes së ritmit të procesit të implementimit të standardeve, si dhe bren-gosjen për situatën e brishtë të sigurisë.

Institucionet e përkohshme të Kosovës duhet të bëjnë veprime të vendosura drejt përmirësimit të përgjegjësisë politike dhe implementimit të standardeve për një shoqëri

demokratike dhe multietnike, e cila edhe pas definimit të statusit final do t'i bëjë të mundur Kosovës që të mbajë vetveten në mënyrë të qëndrueshme dhe t'i mundësojë integrimin evropian.

Respekti i të drejtave të të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe pjesëtareve të tyre, rikthimi i besimit reciprok është një prioritet absolut. Kthimi i qëndrueshëm, reformat e pushtetit lokal, mundësimi i shërbimeve themelore për të gjitha komunitetet, në mënyrë të veçantë për minoritetet, duhet të garantohet, po kështu edhe participimi aktiv i serbëve të Kosovës dhe i minoriteteve të tjera në institucionet e përkohshme dhe në administratën publike. Qëllimi i këtyre reformave duhet të jetë që çdo lloj strukture paralele të bëhet e panevojshme dhe të shpërbëhet.

Ne i bëjmë thirrje Qeverisë së Kosovës dhe të gjitha institucioneve të përkohshme që të shtojnë veprimin e tyre për funksionimin e sundim-

it të ligjit. Bashkimi Evropian duhet të luajë rol më të madh në këtë sektor përmes një mandati dhe pranie adekuate, sidomos përmes misionit të tij të ardhshëm policor dhe në fushën e drejtësisë.

Kosovarët duhet po ashtu të jenë më të kujdesshëm në nevojën e ngutshme për të marrë në duart e tyre ekonominë e tyre, çështjet sociale dhe të ambientit. Zhvillimi

ekonomik i Kosovës, investimet dhe punësimi duhet të mundësojnë stabilitet afatgjatë.

Ne kemi ndjekur gjashtë raundet e bisedimeve në procesin e negociatave për statusin final dhe po përcjellim zhvillimet e fundit pozitive lidhur me trashëgiminë kulturore e fetare; përkrahim zhvillimet e ardhshme konstruktive në fushat më të vështira të decentralizimit, komunave dhe ekonomisë. Këto mund të realizohen nëse të dy palët kanë qëndrime realiste.

Jemi të përcaktuar për vazhdimësi pozitive të gjithëmbarshme të negociatave për statusin dhe shpresojmë se epilogu i tyre do të jetë në frymën e perspektivës së integriteteve evropiane të Kosovës, perspektivë e cila vlen edhe për vendet e tërë rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Parlamenti Evropian trimëron Parlamentin e Kosovës për të vazhduar me zbatimin e standardeve, si hap të rëndësishëm të kontrollit të Qeverisë".

Kombi shqiptar po ecën i lirë, Shqipëria dhe Kosova si dy motra po ecin drejt integritimeve evropatlantike

*Pavarësia e Kosovës është zgjidhja e vetme që garanton paqë dhe stabilitet në Kosovë
Tani është kohë e afrimeve, integritimeve rajonale, fqinjësisë së mirë premtuese e prosperuese, heqjes së të gjitha barrierave ndërmjet vendeve të këtij rajoni*

Me rastin e vizitës së kryeministrit të Shqipërisë, z. Sali Berisha në Kosovë, Kuvendi i Kosovës, i kryesuar nga Kolë Berisha, mbajti sot një seancë solemne. Me këtë rast deputetëve, në mesin e të cilëve ishin edhe kryetari i Kosovës, Fatmir Sejdiu dhe kryeministri i Kosovës, Agim Çeku, iu drejtua kryeministri Sali Berisha.

Në fillim të seancë solemne kryeparlamentari Kolë Berisha i uroi mirëseardhje kryeministrit Sali Berisha për t'iu drejtuar pastaj me këtë fjalë: "Kosova tashmë vizitohet shpesh nga burra shtetesh e personalitete të larta të skenës botërore. Disa prej tyre madje edhe u janë adresuar deputetëve të këtij Kuvendi. Një rast të tillë e kemi edhe sot.

Momentet e këtilla kanë edhe simbolikën e tyre

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që në emrin tim personal dhe në emër të Kuvendit të Kosovës t'iu uroj mirëseardhje Kryeministrit të Shqipërisë, z. Sali Berisha.

I nderuar Kryeministër i Shqipërisë, z. Sali Berisha, mirë se erdhët në Kosovë! Mirë se erdhët në këtë takim me deputetët e Kuvendit të Kosovës!

Momentet e këtilla, krahas rëndësisë, kanë edhe simbolikën e tyre. Është dashur të kalojë kohë tepër e gjatë deri te ky moment: Kryeministri i Shqipërisë, për herë të parë, u drejtohet me një fjalim solemn deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Ç'është e vërteta, ju kemi pritur edhe më herët, por nuk ishte e thënë. Nuk ishte shkruar. Ja që sot po realizohet kjo vizitë.



Pak vjet më parë, Prishtina dhe Tirana ishin shumë larg njëra-tjetrës, në distanca gjeografikisht pothuaj të paarrtshme, ose, më saktë, të pakalueshme. Larg ishte madje edhe Tropoja, vendlindja e kryeministrit Berisha, e cila është mu në kufirin me Kosovën.

Ishte kështu sepse rajoni ynë, Ballkani, njëlhte vetëm ideologji përjashtuese, meskine, barriera, kufij, urrejtje dhe frikë nga njëri-tjetri. Tani, për fat të mirë, nuk është më kështu. Ajo është kohë e shkuar. Mos e pafshim kurrë më! Tani jemi në një kohë tjetër.

Sot, Prishtina dhe Tirana janë shumë më afër. Do të afrohem akoma më shumë. Sepse kjo është dëshirë jona. Sepse kjo është kohë e afrimeve, integritimeve rajonale, fqinjësisë së mirë premtuese e prosperuese, heqjes së të gjitha barrierave ndërmjet vendeve të këtij rajoni.

Jam i sigurt se nuk ka nevojë të bëjmë ndonjë prezantim të veçantë figurës dhe personalitetit të z. Sali Berisha, sepse e njihni dhe e njohim të gjithë. E njohim mirë dhe për të mirë.

Por, para se ta ftojme në foltore, më lejoni të konstatoj se prania e z. Berisha mes nesh është një rast i mirë që t'iu shprehim mirënjohje për meritat e tij të veçanta në përkrahjen e gjithanshme dhënë Kosovës, në

ditët e golgotës, nën dhunën e soldateskës së Milosheviqit;

T'iu shprehim mirënjohje të veçantë për meritat e tij të mëdha në ditët e lindjes së demokracisë dhe të përmbyshjes së totalitarizmit në Shqipëri, në fillim të viteve '90.

Dhe, veçanërisht është rast i mirë ta përgëzojmë për lajmin e mirë që na erdhi pak para tij, nënshkrimi i Marrëveshjes së Asocim-Stabilizimit të Shqipërisë me Bashkimin e Evropian. Ky është lajmi i mirë edhe për Kosovën dhe për tërë Ballkanin Perëndimor.

Duke ju uruar, për këtë arritje madhore, z. Kryeministër Berisha, ju ftoj në foltoren e Kuvendit të Kosovës. Urdhëroni!"

Deputetëve të Kuvendit të Kosovës pastaj iu drejtuar kryeministri i Shqipërisë, prof. Dr. Sali Berisha, i cili në fillim, në emër të qeverisë dhe qytetarëve të Shqipërisë përcolli përshëndetjet më të përzemërta, mirënjohjen më të thellë, mbështetjen më të plotë dhe të gjithanshme për ecjen përpara në përpjekjen për realizimin e aspiratave dhe idealeve legjitime të qytetarëve të Kosovës.

Në vijim kryeministri tha: "Unë vij në Kosovë vetëm tre ditë pas përvjetorit të shtatë të çlirimit të Kosovës dhe vetëm tri ditë pasi Shqipëria firmosi me Bashkimin e Evropian Marrëveshjen e Stabilizim-

Asocimit, duke lënë kështu prapa tranzicionin dhe duke konsoliduar në mënyrë të pakthyeshme rrugën e saj drejt bashkimit në familjen e popujve dhe shteteve evropiane. Kombi shqiptar ecën i lirë dhe i sigurt drejt të ardhmes. Kosova dhe Shqipëria, si dy motra të dashura ecin drejt Bashkimit Evropian dhe NATO-s, drejt së ardhmes që e meritojnë.

12 qershori i vitit '99 është një ngjarje e madhe në historinë e lirisë dhe të paqes, jo vetëm për Kosovën, por për të gjithë Ballkanin dhe Evropën, NATO-n dhe vendet e saj anëtare. Në këtë përvjetor duhet të shpreh mirënjohjen më të thellë atyre që shndërruan në realitet ëndrrën e lirisë së qytetarëve të Kosovës, ëndrrën time të madhe. Zoti i bekoftë ata, vendet dhe kombin e tyre.

Të ndërtojmë së bashku Kosovën evropiane

Por, unë këtu para jush duhet të përulem me nderim të madh për qëndresën mbinjerëzore të qytetarëve të Kosovës, sakrificën e tyre sublime për liri, dinjitet, nder, identitet kombëtar dhe evropian. Unë gjithashtu duhet të shpreh admirimin tim për ju të dashur deputetë dhe deputete të Kosovës, që brenda pak vitesh shndërruat këtë Kuvend në tempull të vërtetë, promotor të shfrytëzimit dhe mbrojtjes të vlerave të lirisë, hartimit dhe miratimit të ligjeve, normave, akteve të ndërtimit të demokracisë, shtetit ligjor të Kosovës evropiane, Kosovës së qytetarëve të barabartë para ligjit, pavarësisht nga përkatësia etnike, Kosovës që ecën sigurt drejt hapësirave të integritetit evropian-atlantik.

Gjatë qëndrimit tim në Kosovë pata rastin të takohem me personalitetet më të larta të vendit, me kryeadministratorin, me presidentin, kryeministrin, kryetarin dhe Kryesinë e Parlamentit dhe do të takohem edhe me udhëheqësit kryesor politik të vendit, përfshirë edhe ata të komuniteteve pakicë, dhe me kënaqësi

konstatoj se mesazhi i përbashkët i të gjitha këtyre takimeve është të punojmë së bashku pa dallim kombëtar, racor, fetar për të ndërtuar Kosovën evropiane.

Gjatë kësaj vizite, por edhe nga ndjekja e vazhdueshme e zhvillimeve në Kosovë konstatoj me kënaqësi se në Kosovë është arritur një progres i madh dhe i ndjeshëm në ruajtjen e stabilitetit dhe qetësisë së brendshme, në realizimin e standardeve të kërkuara për një shoqëri dhe shtet demokratik multi-etnik, në përballimin me zotësi e qartësi politike, me qytetari dhe profesionalizëm të lartë të procesit të negociatave. Këto arritje frymëzuese, shpresëdhënëse kanë ardhur si rezultat i dëshirës suaj, i vullnetit tuaj të qartë politik të përbashkët për të ndërtuar institucione demokratike, gjithëpërfshirëse, funksionuese, bazuar në vlerat perëndimore që garantojnë respektimin e të drejtave e të lirisë të individit dhe pakicave në një shoqëri dhe vend të lirë. Kjo punë e begatë, që është bërë, nuk do të kishte qenë kaq e arritur pa ndihmën e faktorit ndërkombëtar, UNMIK-ut, KFOR-it në veçanti. Këta burra dhe gra nga gjithë bota sollën gjithë këto vite në Kosovë eksperiencën më të mirë të vendeve të tyre, i aplikuan këtu atë eksperiencë së bashku me ju, rindërtuan Kosovën, ndërtuan institucione demokratike dhe shtet ligjor, shoqërinë civile, garantuan rendin, qetësinë, stabilitetin në territorin e Kosovës dhe rrezatuan atë në mbarë rajonin. Për këtë duhet t'u jeni mirënjohës jo vetëm ju, por edhe të gjithë ne të tjerët.

Sot ndodhemi para një momenti historik për Kosovën, në të cilën procesi ndërkombëtar për statusin po ecën drejt përmbylljes. Unë bashkohem me të gjithë personalitetet e larta që takova në Kosovë, se procesi politik drejt statusit është në rrugën e duhur dhe se e ardhmja e Kosovës duhet të jetë shteti i pavarur, sovran, demokratik dhe i integruar në Bashkimin Evropian dhe në NATO.

Shqipëria mbështet fuqishëm parimet bazë mbi zgjidhjen e statusit

Shqipëria ka qenë dhe mbetet faktor i rëndësishëm, aktiv dhe konstruktiv për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Qëndrimi i Shqipërisë për Kosovën është i qartë, ne mbështesim fuqimisht përpjekjen e komunitetit ndërkombëtar, Këshillit të Sigurimit, Grupit të Kontaktit dhe Misionin e të dërguarit special të Sekretarit të përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, presidentit Marti Ahtisari, së bashku me përfaqësuesit e Kosovës për gjetjen e një zgjidhjeje që merr parasysh vullnetin e plotë të popullit të Kosovës. Shqipëria gjithashtu mbështet fuqishëm parimet bazë të formula-ara nga këto organe ndërkombëtare mbi të cilat do të ndërtohet kjo zgjidhje, jo kthim në situatën e para vitit 99, jo ndarje e Kosovës, jo bashkim me ndonjë vend apo pjesë të ndonjë vendi tjetër. Në mendojmë se prezenca ndërkombëtare civile dhe ushtarake është e domosdoshme për Kosovën dhe rajonin për një periudhë të caktuar pas statusit.

Gjithashtu, është momenti që të shprehim mirënjohjen e thellë për punën dhe kontributin e shkëlqyer të shefit të UNMIK-ut, Soren Jesen Petersen, i cili largohet duke mbetur një mik i madh i shqiptarëve dhe jo vetëm i Kosovës, por edhe i vendeve tjera për kontributin dhe vizionin që mbrojti gjatë qëndrimit të tij në krye të kësaj organizate ndërkombëtare në Kosovë. Por, ne besojmë se puna e shkëlqyer e zotit Petersen në Kosovë do të vijohet edhe më tej nga UNMIK-u deri në përfundimin e negociatave dhe sigurimin e statusit final të Kosovës. Për Shqipërinë pavarësia e Kosovës është zgjidhja e vetme që garanton paqe dhe stabilitet në Kosovë, por jo vetëm në Kosovë, por edhe në vendet tjera përreth.

Paqja, stabiliteti dhe konsolidimi i tyre në Kosovë kanë një rëndësi të madhe për Shqipërinë, Maqedoninë,

Malin e Zi dhe Ballkanin në tërësi. Por, konsolidimi i tyre është një proces i vështirë dhe jetik, trashëgimi e hidhur. Varfëria, dobësia e shtetit ligjor, krimi i organizuar, korrupsioni, terrorizmi janë ndër faktorët që rrezikojnë sigurinë dhe stabilitetin, si në Kosovë ashtu edhe në vendet tjera të Ballkanit dhe më gjerë. Por, në Kosovë sikundër në tërë Ballkanin, rëndësi të dorës së parë për paqe dhe stabilitet ka respektimi i lirive dhe të drejtave të pakicave, gjuhës, kulturës, arsimit, besimeve fetare të tyre. Qëndrimi ndaj anëtarëve të pakicave në tërësi dhe pakicës serbe në veçanti është një provë dhe përgjegjësi e madhe morale dhe ligjore kombëtare e ndërkombëtare e qytetarëve shqiptarë në Kosovë, provë e vizionit të tyre për Kosovën evropiane dhe të pavarur, provë e qëndrimit të tyre ndaj interesit jetik kombëtar, por edhe provë e mirënjohjes së tyre ndaj atyre që për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave njerëzore të shqiptarëve në Kosovë ndërhyjnë në qershorin e vitit '99. Unë përshëndes platformën e decentralizimit dhe kuadrin ligjor të garantimit të lirive dhe të drejtave të njeriut të udhëheqjes suaj politike, si dokument i shkëlqyer që mishëron parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Minoriteteve dhe të asaj mbi Autonominë Lokale dhe Rajonale të Qeverisjes Vendore. Kam besimin më të madh në përkushtimin tuaj të plotë për jetësimin e tyre. Unë jam i sigurt se trashëgimia kulturore, fetare, kishat, manastiret e serbëve që janë njëkohësisht një pasuri e çmuar e Kosovës dhe mbarë Evropës do mbrohen dhe ruhen siç janë mbrojtur dhe ruajtur në shekuj në Kosovë nga shqiptarët.

Pajtimi shoqëror në Kosovë është në interesin jetik kombëtar

Qeveria e Kosovës ka bërë dhe bën përpjekjet më serioze për rikthimin e të shpërngulurve në Kosovë, por të gjitha këto nuk mund të zëvendëso-

jnë rëndësinë jetike të faljes, pajtim-it, amnistisë në Kosovë. Prandaj, nga kjo katedër nderi, unë u bëj një thirrje vëllazërore të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe në veçanti atyre dhjetëra dhe mijëra baballarëve, nënave, vëllezërve, motrave që kanë humbur më të dashurit e tyre të gjejnë forcë shpirtërore për të falur. Të falësh nuk do të thotë kurrë të harrosh, përkundrazi është mënyra më fisnike që të nderosh dhe përjetësosh kujtimin e më të dashurit tënd. Kjo është rruga e vetme për të shndërruar në virtyt, madje në virtytin më të mirë sakrificën e tij sublime, për të shtruar në dritën e së ardhmes shpirtin e njeriut tënd të dashur, për të lartësuar së bashku me të ngrehinën madhështore të Kosovës së lirë. Të falësh, dëshmon se di të dallosh viktimën nga fajtori dhe se e ke të qartë se Milosheviqi nuk ishte vetëm armiku yt, porse ai ishte armik edhe i popujve të tjerë.

Pajtimi shoqëror në Kosovë është në interesin jetik kombëtar dhe këtu e kam fjalën për interesin kombëtar në tërësi. Ky interes kërkon të mbahen gjithnjë parasysh se qëndrimi ndaj pakicës serbe ka një rëndësi shumë të madhe për marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe serbëve në Ballkan. Dy popuj që në interesin e tyre më të mirë, por edhe në traditën dhe mësimin e mrekullueshëm të kombeve të qytetëruara, duhet ta marrin të gjitha përgjegjësitë dhe të hapin një kapitull të ri bashkëpunimi, miqësie e integrimi të përbashkët në Evropë. Unë duhet gjithashtu t' u dërgojë një thirrje miqësore përfaqësuesve të pakicës serbe në Kosovë, duke kërkuar garantimin e qarkullimit të lirë dhe të drejtave që u takojnë, të përfshihen në jetën aktive të vendit të tyre dhe të japin ndihmesën e tyre në konsolidimin e bashkëjetesës, harmonisë ndëretnike në Kosovë, si interesi më i mirë i tyre dhe i fëmijëve të tyre. U bëj thirrje të mos dëgjojnë sirenat e manipulimit nacionalist, por të besojnë dhe mbështesin vizionin evropian të

Kosovës së lirë dhe të pavarur. Dëshiroj të nënvizoj se Shqipëria dhe Kosova kanë interesa të përbashkëta në të gjitha fushat, për të cilat është punuar, por kërkohet akoma më shumë të punojnë në të ardhmen. Kosova nëpërmjet porteve të Shqipërisë afrohet më shumë me Evropën. Këtij synimi i shërben edhe zgjerimi i Portit të Shëngjinit, përshpejtimi i punës për realizimin e superstradës Durrës-Morinë-Merdar-Nish dhe më tutje. Edhe Kosova edhe Serbia kanë probleme me portet. Janë të mirëpritura. Adriatiku ka gjithë ato porte. Republika e Shqipërisë e konsideron Kosovën pjesë të proceseve demokratike dhe integruese në rajon dhe më gjerë, prandaj kemi mbështetur dhe do të vijojmë edhe në të ardhmen të mbështesim përfshirjen dhe përfaqësimin tuaj në të gjitha nismat shumëpalëshe, në rritjen e shkëmbimeve politike dhe zgjerimin e bashkëpunimit tuaj me vendet e rajonit, me organizmat ndërkombëtare, me Bashkimin Evropian dhe NATO-n. Në përfundim, më lejoni t'ju siguroj edhe njëherë mbështetjen e plotë të Qeverisë së Shqipërisë për përparimin pozitiv të procesit që tashmë ka marrë udhë në Kosovë për ndërtimin e një shteti të lirë, të pavarur, demokratik, multietnik, që garanton, respekton të drejtat e njeriut dhe pakicave, i një shteti të ri të orientuar drejt integritetit euro-atlantik, i një Kosove - faktor paqe e stabiliteti në Ballkan. Rroftë Kosova”!

Pas kësaj fjale të ngrohtë, Kolë Berisha falënderoi kryeministrin me këto fjalë: “ Në emër të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, ju falënderoj për fjalët e mira që thatë. Dhe, më lejoni t'ju shpreh edhe një herë falënderimet tona për çdo fjalë të mirë që keni thënë për Kosovën, qoftë si President i Shqipërisë, apo si lider i opozitës, në organizatat ndërkombëtare, gjatë viteve të vështira kur Kosova nuk mund të merrte pjesë me përfaqësuesit e saj”

Parlamentarizëm më funksional, mbikëqyrje më efektive të Qeverisë

Në përpjekje për të lëvizur drejt një shoqërie progresive dhe demokratike Kuvendi i Kosovës ka aprovuar planin për standarde. Gjatë seancës së sotme plenare Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha ka deklaruar se këto ndryshime janë iniciuar në përpjekje për të krijuar një Kuvend i cili do të funksionojë në përputhje me standardet e parlamenteve të vendeve të tjera demokratike. Këto ndryshime kryesisht përfshijnë iniciimin e periudhave më dinamike të pyetjeve parlamentare dhe po ashtu prezantimin e debatit parlamentar dy orësh që do të zhvillohet në secilën seancë plenare rreth një çështje të caktuar të zgjedhur nga opozita. Së fundi, Kuvendi ka aprovuar përpilimin e planit vjetor të punës dhe mbajtjen e seancave plenare së paku dy herë në muaj. “Para tre muajve, ju më zgjodhët Kryetar të Kuvendit të Kosovës. Ju premtova, atë ditë se do të jem në shërbimin tuaj në mënyrë që të ngrisim vlerat demokratike të institucionit tonë. Plani i sotëm është rezultat i konsultimeve të vazhdueshme me deputetët e Kuvendit, me Qeverinë dhe miqtë tanë ndërkombëtar. Në këto momente historike, kur të gjithë i kanë sytë të drejtuar kah Kosova, ka ardhur momenti të shkojmë një hap përpara” deklaroi Kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Kolë Berisha. Plani i Kuvendit për standarde do të përmirësojë funksionimin e Kuvendit dhe do të mundësojë mbikëqyrjen më efektive të Qeverisë.

Çfarë risish sjellin reformat në jetën parlamentare?

Shumë shqetësime janë shprehur lidhur me funksionimin transparent dhe demokratik të Kuvendit të Kosovës dhe lidhur me procedurat e përdorura në të. Kuvendi i Kosovës ka vendosur që të merret me këto shqetësime në mënyrë që institucioni më i lartë vendor t’iu afrohet

standarde dhe praktikave të parlamenteve në mbarë botën. Gjatë disa muajve të ardhshëm, do të bëhen disa ndryshime të cilat kanë për synim që dukshëm të përmirësojnë funksionimin, menaxhimin dhe administrimin e institucionit tonë. Këto ndryshime do të ndihmojnë edhe në plotësimin e planit të standardeve për të cilën do të flitet në Këshillin e Sigurimit të OKB-së në qershor.

Pika e parë e reformave është miratimi i një kalendar vjetor të punës së Kuvendit të Kosovës. Gati çdo parlament në botë publikon një kalendar të tillë. Përmes këtij kalendari deputetët dhe opinioni i gjerë njoftohen me datat e seancave plenare, mbledhjeve të Kryesisë dhe mbledhjeve të tjera të rregullta. Plani i miratuar ofron mundësi për më shumë seanca të rregullta dhe fikse me qëllim që punët të kryhen në mënyrë më të rregullt. Seancat do të mbahen dy herë në muaj gjatë periudhave normale të punës dhe tri herë në muaj gjatë periudhave më intensive të punës. Një javë para seancës do të mbahen mbledhje të rregullta me kryetarët e komisioneve (të marteve), me shefat e grupeve parlamentare (të mërkurave) dhe me kryesinë (të enjteve). Normalisht muaji gusht parashihet si muaj pushimi, edhe pse këtë vit mund të ketë përjashtim. Pika e dytë e reformave, që është e afërt me të parën, ka të bëjë me kalendarin e aktiviteteve të Kryesisë. Ky kalendar i hollësishëm do të miratohet nga Kryesia çdo dy muaj dhe do të ndihmojë në organizimin më të mirë të punës së saj.

Pika e tretë e reformave, është plani i standardeve që ka për qëllim të forcojë sovranitetin e Kuvendit dhe përmirësoj llogaridhënien e Qeverisë. Kërkesat e këtij plani janë shumë të qarta:

Të ketë periudhë të rregullt për pyetje parlamentare;
Interpelanca të rregullta të iniciuara nga grupet parlamentare;

Plani për mbështetje teknike të komisioneve;

Plani i brendshëm i administratës;

Projekt-buxheti i iniciuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe i miratuar nga Kryesia;

Përmirësime në menaxhimin e sistemit informativ; dhe

Media dhe publiku kanë qasje në dokumente zyrtare.

Pse shtrohen pyetjet parlamentare?

Pyetjet parlamentare mund të parashtrihen nga çdo deputet për të kërkuar informacione apo për të kërkuar veprim ndaj një çështje të caktuar.

Pyetjet i obligojnë ministrat që të shpjegojnë dhe justifikojnë punën e tyre, vendimet dhe aktivitetet në ministri. Deputetët e shfrytëzojnë këtë të drejtë duke parashtruar pyetje gjatë “kohës së parashikuar për pyetje”. Kërkesa për informacione dhe shpjegime gjatë kohës së parashikuar për pyetje është një nga përgjegjësitë vitale të deputetëve dhe paraqet një nga elementet e mbikëqyrjes parlamentare të qeverisë. Pyetjet parashtrihen paraprakisht me shkrim duke u ofruar anëtarëve të qeverisë kohë për t’u përgatitur. Ministri përkatës duhet të jetë i njoftuar së paku 2 ditë para seancës plenare në mënyrë që ai të jetë i përgatitur të përgjigjet në pyetjen specifike. Edhe pse pyetjet parlamentare mund të parashtrihen nga secili deputet, periudha e pyetjeve parlamentare tradicionalisht konsiderohet si “koha e opozitës”.

“Koha e parashikuar për pyetje” paraqet një periudhë të caktuar në kuadër të seancës plenare ku deputetët dhe veçanërisht deputetët nga opozita, parashtrojnë pyetje për anëtarët e qeverisë, të cilët duhet të përgjigjen me gojë aty për aty.

Model brilant i veprimit dhe i reagimit të politikanit të matur e të vendosur

- **BERISHA:** *Kosova, në historinë e saj, shpesh i ka ndier në kurriz dhe i ka vuajtur pasojat e paraqitjes së shtrembëruar të fakteve dhe të rrethanave para botës. Prandaj, i konsiderojmë miq dhe nuk i harrojmë kurrë të gjithë ata që e thanë të vërtetën për ne. Pikërisht këtë e keni bërë ju, z. Petersen dhe Kosova ju është mirënjohëse*
- **PETERSEN:** *Të gjitha ndryshimet në udhëheqje (në presidencë, Qeveri dhe Kuvend) pas vdekjes së Rugovës, janë bërë duke i respektuar rregullat demokratike dhe njëherësh duke i befasuar për të mirë shumë vende demokratike të botës, e që janë vlerësuar edhe nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së*



Me rastin e përfundimit mandatit të z. Soren Jessen Petersen, në misionin e PSSP-së në Kosovë, Kuvendi i Kosovës e ftoi atë në një takim lamtumirës në seancën e Kuvendit të Kosovës, më 29 qershor 2006. Në fillim Kolë Berisha me fjalë të zgjedhura foli për kontributin e rëndësishëm të Petersenit gjatë kohës sa udhëhoqi ai këtë mision. Kreu i i legjislativit të Kosovës, Berisha, me këtë rast tha: “Koha ecën shpejt kur udhëton me njerëz të mirë. Z. Petersen, ne bëmë bashkë

një copë rrugë dhe shumë shpejt erdhi edhe kjo ditë e ndarjes. Do të donim të zgjaste akoma qëndrimi juaj këtu për të finalizuar bashkërisht proceset për të cilat punuam këto vite. Sidoqoftë, i kuptojmë arsyet tuaja të largimit.

Do t’ju kujtojmë gjatë dhe shpesh. Në çdo situatë – sepse na latë një model brilant të veprimit, të reagimit të politikanit të matur e të vendosur njëkohësisht. Na latë një model të njeriut veprues, që në momentin e duhur është në vendin e duhur, qoftë për të zhbllokuar procese, apo për

t’u dhënë shpirt projekteve të ndryshme.

Kosova, në historinë e saj, shpesh i ka ndier në kurriz dhe i ka vuajtur pasojat e paraqitjes së shtrembëruar të fakteve dhe të rrethanave para botës. Prandaj, i konsiderojmë miq dhe nuk i harrojmë kurrë të gjithë ata që e thanë të vërtetën për ne. Pikërisht këtë e keni bërë ju, z. Petersen dhe Kosova ju është mirënjohëse.

Ju na dhatë modelin e njeriut që ka guxim ta thotë të vërtetën dhe ta mbrojë atë. Jeni modeli i veprimit

harmonik të njeriut dhe politikanit.

Do të krenohemi për çdo gjë që kemi bërë bashkërisht gjatë këtyre viteve në Kosovë

Kemi kaluar gjatë këtyre dy viteve edhe çaste të vështira, por në përpjekjet e tejkalimit të tyre na është forcuar dëshira për bashkëpunim. Besimi lehtëson bashkëpunimin. Përmes jush bota na ka kuptuar me lehtë. Veç kësaj, ju do të bëni akoma për Kosovën, kudo që të jeni. Për këtë jemi të sigurt.

Z. Petersen, duhet ta dini se ne ju kemi besuar kur na thatë këto ditë se do ta keni me vete Kosovën dhe ndjenjën e miqësisë për të.

Me angazhimin tuaj të palodhshëm keni vënë një gur të madh, të fortë në themelin e institucioneve të Kosovës me të cilin shpresoj se do të krenoheni, siç do të krenohemi ne për çdo gjë që kemi bërë bashkërisht gjatë këtyre viteve në Kosovë.

Më vjen mirë që kam rastin t'ua them këto gjëra për zemërsisht e sinqerisht dhe nuk janë vetëm fjalë kurtoazie që thuhet në momente ndarjesh. Por, edhe më mirë me vjen që ju e dini, të gjithë e dinë, se këto janë fjalë që i mendojnë edhe qytetarët e Kosovës.

Tani, ky takim është i fundit kur do të këmbëjmë edhe ndonjë mendim bashkërisht me ju në cilësinë e Shefit të UNMIK-ut, por, pas kësaj dite, nuk do të jeni më në këtë cilësi, por do të vazhdoni të jeni vetëm mik i Kosovës. Dhe, kjo është shumë. Madje, në traditën tonë, kjo është e shenjtë.

Sot, unë dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës, institucionet dhe qytetarët e Kosovës, kemi vetëm një përshëndetje: Mirupafshim, z. Petersen! Pra, mirupafshim sa më shpejt! Kurdoherë që t'u jepet rasti, do të na gëzoni me vizitën tuaj. Ju tashmë jeni pjesë e Kosovës, zoti Petersen.

Tani, foltorja është për ju z. Petersen".

Pastaj fjalën e mori z. Petersen. Në fillim të fjalës së tij para deputetëve

të Kuvendit të Kosovës Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Kosovës Soren Jessen Petersen, ka përshëndetur kryetarin Sejdiu, kryeministrin Çeku, kryeparlamentarin Berisha dhe të gjithë parlamentarët e Kosovës, kurse ka falënderuar Kryesinë e Kuvendit për këtë fjalim lamtumirës, para se të largohet nga Kosova. Ai ka pranuar se ka emocione dhe se e ka vështirë që të largohet nga Kosova, pas punës që ka bërë me përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës gjatë dy viteve në krye të UNMIK-ut.

Petersen i ka quajtur moment krenarie zgjedhjet parlamentare të vitit 2004 dhe ka përkujtuar se regjimi i Beogradit u kishte sugjeruar serbëve të Kosovës që të mos merrnin pjesë në zgjedhje. Ai e ka vlerësuar se është dashur të mësohet praktika e funksionimit të pushtetit qendror me pozitë dhe opozitë, duke theksuar se sa është e rëndësishme kjo për diversitetin e demokracisë. Kryeadministratori, Petersen, me këtë rast, ka përkujtuar vështirësitë e krijimit të koalicionit qeverisës, por edhe përballimin me sukses të momenteve të vështira të dorëheqjes së kryeministrit Haradinaj, ngjarje kjo që ka pasur mundësi të krijojë destabilitet, por e cila është menaxhuar denjësisht. Ai, ndërkaq, ka lavdëruar punën e madhe të institucioneve të Kosovës për përmbushjen e standardeve.

Rugova vdiq pa e parë realizimin e ëndrrës së tij

Ndër momentet e vështira për të dhe për Kosovën, Petersen ka përmendur sëmundjen e presidentit Rugova dhe vdekjen e personifikimit të aspiratës së popullit tij, pa e parë realizimin e ëndrrës së tij. Petersen, ndërkaq, ka pohuar se të gjitha ndryshimet në udhëheqje (në presidencë, Qeveri dhe Kuvend) pas vdekjes së Rugovës, janë bërë duke i respektuar rregullat demokratike dhe njëherësh duke i befasuar për të mirë shumë vende demokratike të botës, e që janë vlerësuar edhe nga Këshilli i

Sigurimit i OKB-së. Peterseni, në fjalën e tij para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, vëmendje të veçantë i ka kushtuar fillimit të bisedimeve për statusin e vendit dhe emërimin e Ahtisarit, si kryenegociator, duke u shprehur i bindur se statusi i Kosovës do të përcaktohet brenda pak muajsh. Ai ka tërhequr vërejtjen se vonimi i përcaktimit të statusit nuk do të jetë i mirë as sa i përket stabilitetit të rajonit. Petersen ka thënë se zgjidhja duhet të jetë e pranueshme për shumicën e popullit të Kosovës, por njëherësh edhe për pakicën.

Ndër sukseset e punës së tij në Kosovë, Petersen ka përmendur bartjen e kompetencave në institucionet e vendit. Ai ka pohuar se është angazhuar të krijojë bindjen në UNMIK e më gjerë se, institucionet e Kosovës duhet të jenë përgjegjëse për vendin. Duke folur për zhvillimin ekonomik të Kosovës, Petersen ka pranuar se me gjithë përparimet e dukshme, nuk ka arritur të zvogëlohet papunësia e madhe në Kosovë. Ai është angazhuar që të krijohen kushte për investimin e kapitalit të huaj në Kosovë dhe kësajsoj edhe shtimin e vendeve të punës për të rinjtë.

Serbët e Kosovës shpejt do të çlirohen nga kjo tutori e Beogradit

Petersen ka pohuar se ka qenë detyrë e misionit të tij në krye të misionit të UNMIK-ut në Kosovë që të krijojë kushtet për një shoqëri multietnike, se ka punuar shumë në këtë plan, sidomos për kthimin e serbëve. Ai ka theksuar se ka ndryshime pozitive në sjelljen e njerëzve të Kosovës, sa i përket kthimit, por se pengesa ka shkaktuar politika destruktive e Beogradit. Ai është shprehur optimist se serbët e Kosovës shpejt do të çlirohen nga kjo tutori dhe se vetë do të bëjnë zgjedhjen. Kosova ka qenë multietnike, është dhe do të jetë multietnike ka thënë Petersen. Pas përcaktimit të statusit Kosova nuk do të dështojë dhe serbët e Kosovës

do të gjejnë mundësi të gjëra të përparimit në të ka pohuar kreu u UNMIK-ut.

Në duart tuaja Kosova do të jetë e fuqishme

Duhet të krenohemi me të arriturat e Shërbimit Policor të Kosovës, ka thënë Petersen duke folur për mekanizmat e sigurisë në Kosovë dhe ka shtuar se Kosova duhet të bëhet vend i sundimit të ligjit. Kam parë rritjen tuaj dhe pjekurinë tuaj për tu ballafaquar me sfidat që ju dalin, ka theksuar Petersen. Në duart tuaja Kosova do të jetë e fuqishme ka thënë Petersen, i cili ka shprehur admirim me durimin e njerëzve të

fshatrave dhe të qyteteve të Kosovës, në përballje me vështirësitë e jetës. Ai e ka vlerësuar privilegj që i është dhënë rasti të punojë për këta njerëz dhe për Kosovën.

Vullneti i shumicës së popullit të Kosovës është pavarësia, ka thënë Petersen, i cili ka sugjeruar që ëndrra e shumicës të ndahet me komunitete të tjera; që kjo ëndrra të mos bëhet ankth për të tjerët.

Mik i përjetshëm i Kosovës

Kudo që të jem do të vazhdoj të punoj për njerëzit e Kosovës, ka thënë Petersen, i cili është zotuar se gjithmonë do të jetë një mik i

Kosovës. Kur ëndrra e juaj të bëhet realitet, mezi pres ta ndaj me ju këtë moment madhështor ka përfunduar Petersen. Petersenit i dhurohet "Hyjnesha në fron" Në përfundim të fjalës së kryeadministratorit Petersen, kryeparlamentari Berisha i ka dhuruar atij një vepër artistike me motive të "Hyjneshës në fron" që dokumenton lashtësinë e civilizimit të kësaj pjese të Evropës. Më pastaj Petersen ka pirë kafe miqësisht me deputetët e Kuvendit të Kosovës. Para se të fillonte seanca kryeadministratori Petersen ka pasur një takim me kryeparlamentarin Berisha, në të cilin është biseduar për bashkëpunimin e shkuar dhe në të ardhmen.

Përprojekje për të gjetur zgjidhje rreth ndërtimit të objektit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kolë Berisha, sipas iniciativës së tij, kishte sot një takim me përfaqësuesit e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe të OSBE-së, përkitazi me ndërtimin e objektit të ASHAK-së. Përfaqësuesi i Komunës së Prishtinës nuk erdhi në takim. Në fillim kryeparlamentari theksoi se jemi tubuar këtu, në kuadër të përprojekjeve për të gjetur zgjidhje rreth ndërtimit të objektit të një institucioni me rëndësi të veçantë, siç është Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës. Përprojekjet për ndërtimin e këtij objekti bëhen duke u angazhuar edhe në drejtim të

gjetjes së një alternative të duhur për Institutin Gjyqësor të Kosovës, i cili gjendet në vendin ku duhet të ndërtohet Akademia.

Kryetari i ASHAK-së, Rexhep Ismajli, paraqiti edhe një herë ecurinë e përprojekjeve për ndërtimin e këtij objekti, si dhe momentet e vështirësimit të kryerjes së tij, që kanë të bëjnë me Institutin e Gjyqësisë. Ai tha se për shkak të mos fillimit të punëve ndërtimore është dashur të kthehen mjetet financiare dy herë. Ministri i Drejtësisë, Jonuz Salihaj dhe ministri i Arsimit, Agim Veliu, duke i paraqitur qëndrimet e tyre sikur se edhe bashkëbiseduesit tjerë u pajtuan se objekti i Akademisë duhet të ndërtohet aty ku është planifikuar,

ndërsa për Institutin e Gjyqësisë duhet të gjendet një zgjidhje deri sa të bëhet objekti i Ministrisë së Drejtësisë. Zhvendosja e institutit duhet të bëhet, sepse kjo parashihet edhe me planin urbanistik të Prishtinës. Përfaqësuesi i Presidencës së Kosovës, Isa Mustafa transmetoi vendosmërinë e kryetarit të Kosovës Fatmir Sejdiu për të gjetur një zgjidhje sa më shpejt që është e mundur për fillimin e ndërtimit të Akademisë. Me interesim u prit edhe qëndrimi i OSBE-së, nga merrnin pjesë Henri Mc Goven dhe Marice Nyber, e cila është edhe themeluese e Institutit Gjyqësor. Nga përfaqësuesi i OSBE-së u tha se për themelimin e institutit dhe renovimin e tij OSBE-ja ka ndarë mjete të caktuara, por ky institut tash është i Kosovës dhe financohet nga Buxheti i Kosovës, ndaj është me rëndësi të gjendet një objekt adekuat për të. Përfaqësuesi i OSBE-së nuk ishte kundër zhvendosjes së këtij objekti. Të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan që javën e ardhshme të mbahet edhe një takim ku do të raportojë ministri i Drejtësisë, Salihaj, i cili premtoi se do të angazhohet maksimalisht për të gjetur zgjidhje rreth kësaj çështjeje.

Po arrihen rezultate të pamohueshme në demokratizimin e jetës parlamentare

Kuvendi duhet të angazhohet posaçërisht në amendamentimin dhe aprovimin sa më të shpejtë të tri ligjeve që kanë të bëjnë me gjuhët, trashëgiminë kulturore, si dhe bashkësitë fetare

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, **Kolë Berisha**, bashkë me anëtarët e Kryesisë së Kuvendit, kishin sot një takim me shefat e zyrave të ndërlidhjes në Prishtinë lidhur me planin e standardeve dhe të reformës në punën e Kuvendit të Kosovës. Kryeparlamentari Berisha me këtë rast bëri një prezantim të planit të standardeve dhe të reformës në punën e Kuvendit, i cili është aprovuar nga ana e Kuvendit në seancën e fundit. Përkitazi me këtë, kryeparlamentari Berisha theksoi se ashtu si pata premtuar me rastin e zgjedhjes kryetar, se do të angazhohem që Kuvendi të jetë tempull i demokracisë parlamentare, zë i fuqishëm i pozitës dhe i opozitës, i shumicës dhe i pakicës, i transparencës, bashkë me Kryesinë kemi filluar sendërtimin e reformave. Në këtë frymë është bërë kalendari i mbledhjeve të Kuvendit si dhe i takimeve të Kryesisë. Janë bërë edhe ndryshime në rregulloren e Punës së Kuvendit, të cilat mundësojnë realizimin e këtyre synimeve dhe arritjen e standardeve evropiane të punës parlamentare. Në punën e Kryesisë kemi arritur një konsensus, në sajë të të cilit në marrjen e vendimeve nuk vërehen dallime partiake. Në të gjitha këto angazhime, gjithnjë llogarisim në ndihmën e Unionit Evropian. Një pasqyrë shkoqitëse të reformave paraqiti edhe këshilltari politik i kryeparlamentarit, **Ramë Manaj**.

Në fjalët e tyre shefat e zyrave të SHBA-ve, Austrisë, Gjermanisë, Francës dhe Britanisë së Madhe, përkatësisht: **Phillip Goldberg**, **Alexander Bajerly**, **Thierry Reynard**, **Eugen Wollfart**, **David Blunt** ishin të impresionuar me zhvil-



limet aktuale në Kuvendin e Kosovës. Në këtë frymë ata përgëzuan kryeparlamentarin Berisha, si dhe Kryesinë, për rezultatet e pamohueshme që po arrihen në punën e Kuvendit, përkatësisht në demokratizimin e jetës parlamentare, në kuadër të së cilës ndihet një frymë e re. Një nga qëllimet parësore të Kuvendit duhet të jetë posaçërisht hartimi dhe aprovimi i ligjeve në përputhje me legjislacionin më të avancuar ndërkombëtar. Në këtë moment Kuvendi duhet të angazhohet posaçërisht në amendamentimin dhe aprovimin sa më të shpejtë të tri ligjeve që kanë të bëjnë me gjuhët, trashëgiminë kulturore si dhe bashkësitë fetare. U propozua që kjo punë të kryhet më së largu deri në tetor të këtij viti. Shefja e Zyrës së Zvicrës në Prishtinë, **Yvana Enzler** u angazhua për një hapësirë edhe më të madhe për femrat-deputete në të gjitha çështjet që shtrohen në Kuvend. Shefat e zyrave përshëndetën këtë iniciativë, duke shprehur vullnetin që

këso takime të ketë edhe në të ardhmen.

Xhavit Haliti tha se edhe opozita ka dhënë kontributin e saj për të arritur këtë shkallë të demokratizimit të punës, duke vazhduar përpjekje për të gjetur gjuhë të përbashkët në punën parlamentare. Ai në vijim u angazhua që në parlament të krijohen mundësitë që komisionet hetuese parlamentare të ngriten edhe pa shumicën e votave. **Naim Maloku** u ndal më shumë në çështjen e angazhimit të Komisionit Parlamentar për Gatishmëri Emergjente, që krahas marrjes së kompetencave në sferën e sigurisë, të ketë mbikëqyrje parlamentare në këtë fushë. Në këtë kuadër, ai zuri në gojë vizitat shumë të frytshme që kishte bërë ky Komision në Slloveni dhe në Maqedoni. Ndërkaq, **Mahir Jaghillar** foli për mundësitë shumë më të gjera që po krijohen edhe për deputetët nga minoritetet në punën e Parlamentit.

Statusi politik i Kosovës duhet të zgjidhet brenda këtij viti duke marrë për bazë vullnetin e shumicës në Kosovë

Takime në nivel të lartë në Parlamentin Evropian, në Komisionin Evropian dhe në Këshillin e Evropës
Pavarësia e Kosovës është zgjidhja optimale për Kosovën dhe në interes të stabilitetit në rajon
Pritet intensifikim i takimeve dhe komunikimeve ndërmjet Parlamentit të Kosovës dhe Parlamentit Evropian

Sabri Hamiti, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës dhe kryetar i Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Evropian, më 6 e 7 qershor ka qëndruar në Bruksel, ku ka pasur takime në nivel të lartë në Parlamentin Evropian, në Komisionin Evropian dhe në Këshillin e Evropës. Takimet janë zhvilluar me personalitete politike që janë të lidhura me proceset në Evropën Juglindore edhe në Kosovë.

Kryetari i Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë i Parlamentit Evropian, Elmar Brok, në takim me z. Hamiti theksoi se statusi politik i Kosovës duhet të zgjidhet brenda këtij viti duke marrë për bazë vullnetin e shumicës në Kosovë.

Domosdoshmëria për definim të statusit të Kosovës brenda këtij viti u theksua edhe në takimin me z. Stefan Lehne, i dërguar i BE-së në bisedimet për Kosovën. Zgjidhja e statusit do të krijojë kushtet për zhvillimin e saj ekonomik dhe politik dhe për integritet evropian, u tha me këtë rast.

Anëtari i Kryesisë së Kuvendit, Hamiti ka vlerësuar se një takim veçanërisht i rëndësishëm u zhvillua në Drejtoratin Gjeneral për Zgjerim të Komisionit Evropian, me zonjën Genoveva Ruiz Calavera, e cila tani e tutje do ta

drejtojë Deskun, që është krijuar së voni për të ndjekur zhvillimet në Kosovë në aspektet integruese. Kjo zyrë tani e tutje do të ketë veprimtari të përqendruar dhe intensive në komunikim me institucionet e Kosovës nga ana e Komisionit Evropian.

Z. Hamiti ka pasur takime të veçanta edhe me zonjën Doris Pak, e angazhuar për Evropën Juglindore, pastaj me z. Erhard Busek, koordinator i Paktit të Stabilitetit, si dhe me z. Martin Kamp, sekretar gjeneral i Partive Popullore, të cilat e përbëjnë shumicën në Parlamentin Evropian.

Në të gjitha këto takime Sabri Hamiti ka theksuar që pavarësia e Kosovës është zgjidhja optimale për Kosovën dhe në interes të stabilitetit në rajon. Një Kosovë demokratike që garanton të drejtat njerëzore dhe shanset e barabarta për të gjithë. Ai ka nënvizuar në mënyrë të veçantë që Kosova nga aspekti historik, kulturor dhe gjeografik është Evropë, kurse synimi i saj zhvillimor është që të bëhet edhe politikisht Evropë, nëpërmes procesit të integritet, që nënkupton arritjen e standardeve të vlerave universale duke ruajtur edhe vlerat nacionale.

Sipas z. Hamiti në vazhdim do të ketë intensifikim të takimeve dhe komunikimeve më të shpeshta ndërmjet Parlamentit të Kosovës dhe të Parlamentit Evropian.

Komisioni për Gatishmëri Emergjente në Slloveni

Tema qendrore të takimeve gjatë kësaj vizite ishin thellimi i bashkëpunimit ndërmjet parlamentarëve të Kosovës dhe Sllovenisë, posaçërisht në marrjen e përvajave sllovene nga lëmi i kontrollit parlamentar në shërbimet sekrete

Një delegacion i Komisionit për Gatishmëri Emergjente i Kuvendit të Kosovës, kryesuar nga Naim Maloku, kryetar i këtij komisioni dhe anëtar i Kryesisë së Kuvendit, u kthye sot nga një vizitë treditëshe mjaft të frytshme në Slloveni. Delegacioni Parlamentar nga Kosova kishte një agjendë të ngjeshur gjatë kësaj vizite, duke zhvilluar takime të rëndësishme me udhëheqës të institucioneve të larta sllovene. Ky delegacion kishte takim me Këshillin për Politikë të Jashtëme të Kuvendit të Sllovenisë, të kryesuar nga Jozhef Jerovshek, kryetar i këtij këshilli, me sekretarin shtetëror pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, Zvonko Zinraj, me ministrin e Mbrojtjes së Sllovenisë, Karlo Erjavec, biseda me përfaqësues të Ushtrisë së Sllovenisë dhe të Shërbimit Informativ dhe të Sigurisë pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me sekretarin e përgjithshëm të Kuvendit të Sllovenisë, Lovro Lonqar, me kryetarin dhe anëtarët e Komisionit për mbikëqyrjen e shërbimeve të informimit dhe të sigurisë, si dhe me zëvendës drejtorin e përgjithshëm të Agjencisë së Sllovenisë për Informim dhe Sigurim, mr. Janez Zhirovnik. Tema qendrore të këtyre takimeve ishin thellimi i bashkëpunimit ndërmjet parlamentarëve të Kosovës dhe Sllovenisë, posaçërisht në marrjen e përvajave sllovene nga lëmi i kontrollit parlamentar në shërbimet sekrete.

Përfillje të zgjidhjeve më të mira ligjore në kuadër të amendamenteve

Tehu i debatit u orientua posaçërisht në faktin se në kuadër të cilit subjekt do të funksiononte njësi për parandalimin dhe ndalimin e pastrimit të parave

Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga Naser Osmani, kryetar i këtij komisioni, mbajti një dëgjim publik lidhur me Projektligjin për parandalimin e pastrimit të parave. Gjatë debatit u tha se ky Projektligj rregullon një fushë shumë të rëndësishme, siç është pengimi dhe luftimi i pastrimit të parave, si dhe obligimet që kanë institucionet që kryejnë transaksione financiare për të evituar dukuritë negativë në qarkullimin e parasë. Tehu i debatit u orientua posaçërisht në faktin se në kuadër të cilit subjekt do të funksiononte njësi për parandalimin dhe ndalimin e pastrimit të parave. Kishte propozime që ky njësit të veprojë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku do të ishte edhe përfaqësuesi i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, por kishte edhe propozime që kjo njësi të jetë departament, ose agjencion më vete, ose edhe e karakterit mikst. Mirëpo, të gjithë diskutuesit ishin unanim në konstatimin se për të gjitha çështjet që ngërthen ky projektligj duhet të shikohen zgjidhjet që ofrojnë ligjet më të avancuara ndërkombëtare në këtë lëmë.

Në këtë frymë anëtarët e Komisionit u zotuan se do të angazhohen për përfillje të këtyre zgjidhjeve më të mira ligjore në kuadër të amendamenteve që do t'i bëhen Projektligjit, i cili siç u tha, duhet të procedohet e miratohet sa më shpejt në Kuvend. Do theksuar se aktualisht njësit për luftimin e pastrimit të parave vepron në kuadër të UNMIK-ut. Sipas Rregullores në fuqi bankat janë të obliguara të tregojnë prejardhjen e parave që kalojnë shumën prej 10 mijë eurosh, ndërsa me Projektligj ky nivel është 15 mijë euro, kuptohet duke lënë mundësi që në rast dyshimi të hetohen edhe raste nën këtë shumë.

KOMISIONI PARLAMENTAR PËR GATISHMËRI
EMERGJENTE SHQYRTOI GJENDJEN E SIGURISË NË
VERI TË KOSOVËS

Deklarimet për prani ushtarake e policore të Serbisë në Kosovë nuk janë të vërteta

Institucionet dhe segmentet e sigurisë vështrojnë me vigjilencë ngjarjet në veri të vendit

Deklaratat nga kuvendet komunale të veriut të Kosovës se do të bojkotohen institucionet krijuan tensione për qëllime politike



Komisioni për Gatishmëri Emergjente i Kuvendit të Kosovës, i kryesuar nga Naim Maloku, kryetar i Komisionit, shqyrtoi gjendjen e sigurisë në veri të Kosovës, obligim i marrë nga seanca e paradokohshme e Kuvendit të Kosovës përkitazi me këtë çështje. Në mbështetje të shqyrtimit të sotëm, ku ishin të pranishëm edhe ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Fatmir Rexhepi, Nik Bat nga Shtylla e Parë e UNMIK-u dhe Reshat Maliqi gjeneral major i SHPK-së, Komisioni do të hartojë një raport, i cili do t'i paraqitet Kuvendit të Kosovës.

Pas një prezantimi të gjerë të situatës në veri të Kosovës u theksua se deklaratat nga kuvendet komunale të veriut të Kosovës se do të bojkotohen institucionet krijuan tensione për qëllime politike. SHPK bashkë me të gjitha institucionet dhe segmentet e sigurisë ndërkombëtare, me masa shtesë, janë të angazhuara në veprimet e

përditshme të tyre dhe me vigjilencë vështrojnë ngjarjet, ndaj situata në veri është nën kontroll. Qytetarët dhe institucionet e Kosovës treguan pjekuri dhe nuk ranë në provokime të organizimeve në këtë pjesë të vendit. Përgjegjësit e segmenteve të sigurisë theksuan se deklaratimet për prani ushtarake e policore të Serbisë në Kosovë nuk janë të vërteta. Në këtë vështrim ata thanë se gjendja në veriun e Kosovës që 7 vjet vazhdon të jetë afërsisht e njëjtë, ndërsa kjo do të tejkalohet me kthimin e pjesëtarëve serbë në institucionet e Kosovës, për të ndërtuar së bashku të ardhmen e saj.

Lidhur me çështjen se a ka pjesëtarë, ose a po trajnohen pjesëtarë të MUP-it serb për rekrutim në SHPK, u tha se këtu nuk bëhet fjalë për pjesëtarë të cilët kanë dosje për krime të kryera në Kosovë, ata janë qytetarë të Kosovës nga radhët e të gjitha komuniteteve që para lufte kanë shërbyer në shërbimet policore.

Shumë halle e kërkesa, pak mjete

Në pajtim me Rregulloren e punës së Kuvendit, Grupi Parlamentar i PDK-së, i është drejtuar Kryesisë së Kuvendit me kërkesë për të ftuar në interpelancë ministrin e Transportit dhe Telekomunikacionit z. Qemajl Ahmeti

Sipas rregullës 25 pika 6, në fillim të debatit, fjalën e mori përfaqësuesi i PDK-së, z. **Jakup Krasniqi**, i cili në fillim e përshëndeti gatishmërinë e ministrit për t'iu përgjigjur kërkesës për interpelancë. Përgjigjja që kemi marrë nga Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, tha ai, më tepër është një përgjigje, një pyetje parlamentare, sesa një përgjigjeje sipas interpelancës që e kemi bërë. Kjo në një mënyrë tregon se Ministrisë i mungon administrata profesionale, i mungojnë ekspertët, madje i mungojnë edhe këshilltarët të cilët marrin të ardhura të mira nga buxheti i konsoliduar i Kosovës, ndërsa ata nuk i kanë ndihmuar sa duhet ministrit për të na njoftuar për gjendjen e rrugëve në Kosovë. Në përgjigjen e ministrit kemi vetëm një përshkrim të gjendjes së rrugëve në Kosovë. Në përgjigjen e vet Ministria do të duhej të na ofronte planin për sanimin e magjistraleve të Kosovës. Ky plan nuk është, as për një afat emergjent, as për një afat pak më të gjatë.

Ku shkojnë, si shfrytëzohen taksat e qytetarëve për rrugë?

Ministria është dashur të na njoftonte se cilat janë pasojat e gropave në magjistrale të Kosovës, sa ndikojnë ato në trafikun kosovar, cilat janë ndikimet e këtyre gropave në fatkeqësitë në komunikacion? Sa jetë njerëz pësojnë për shkak të gjendjes së keqe në rrugët e Kosovës? Pse? Këto rrugë, sa i kushtojnë buxhetit të qytetarëve të Kosovës. Qytetarët paguajnë taksë për rrugët. Ku shkojnë dhe si shfrytëzohen ato

mjete? A po riparohen rrugët me mjetet e tatimpaguesve që jepen për automjete që kanë. Z. ministër ka qenë i obliguar të na paraqesë një raport më të detajuar për shembjen e dheut në afërsi të Hanit të Elezit. Në raport sikur nuk thuhet asgjë për këtë, a janë respektuar rregullat e tenderimit? Sa i ka kushtuar buxhetit të Ministrisë mbyllja e rrugës dhe pengesat që i janë bërë qarkullimit të mallrave, sa i ka kushtuar buxhetit të konsoliduar të Kosovës?

Kush ka qenë dhe a e ka evidencuar Ministria ndonjë përgjegjësi subjektive dhe cilat janë masat që u morën për ato përgjegjësi? Ndërsa sa i përket korridorit të rrugës Merdar – Morinë, mënyra si është vepruar deri më tani, ka dëmtuar buxhetin e konsoliduar të Kosovës, njëkohësisht ka dëmtuar rëndë ekonominë dhe zhvillimin e saj. Po e pyesim ministrin: pse është shpallur tenderi për projektet pa u kryer studimi i fizibilitetit, studimet e ambientit, studimet gjeomekanike dhe pa bazën e nevojshme ligjore? Sa ka kushtuar tenderi? Sa është vlera e punëve shtesë, përkatësisht përqindja e rritjes nga kontrata e parë në atë përfundimtare? A ka pasur ekspertë vendorë nga Qeveria për monitorimin e projektit? Kush e ka pranuar projektin? Pse nuk është transparent projekti? Pse mbahet larg ekspertëve projekti? Sa do t'i kushtojë projekti këtij korridorit rrugor? Sipas logjikës së veprimit të deritashëm duket se Ministria, sipas përgjigjes së saj, nuk kishte plan se si të dilej nga gjendja e rëndë që ekziston në rrugët e Kosovës dhe jo vetëm në magjistrale, por në të gjitha rrugët e tjera të Kosovës, ku Ministria duhet të jetë mbikëqyrëse, përcjellëse dhe kon-

trolluese e gjithë sistemit rrugor në Kosovë.

Angazhime për shtim të fondeve për mirëmbajtje

Pastaj fjalën e mori ministri **Qemajl Ahmeti** i cili tha se përgjigjja është marrë me shkrim, por dëshiroj të përgjigjem në këto elemente që i parashtrroi kryetari i GP të PDK-së.

Ku shkon taksa rrugore që paguajnë qytetarët e Kosovës me rastin e regjistrimit të automjeteve? Kjo nuk ishte pyetje në kuadër të asaj që kam marrë unë, si pjesë e interpelancës, por përgjigjja është shumë e shkurtër. Taksa rrugore me rastin e regjistrimit të automjeteve shkon në buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe nuk destinohet për rrugë. Pse nuk destinohet, nuk e di, duhet ta dini ju deputetët. Është në buxhetin e përgjithshëm, pastaj bëhet planifikimi i buxhetit të konsoliduar të Kosovës, ndahen segmentet e tjera, ku edhe Ministria e Transportit është një segment, një njësi buxhetore.

Rruga e Kaçanikut është mbyllur me shembjet e para të gurëve. Ka ndodhur me 15 janar. Më 16 janar kam marrë urdhëresën për mbylljen e rrugëve për shkak të sigurisë. Më 17 janar u bë shembja e madhe e dheut. Më 20 janar kemi angazhuar kompaninë që ka qenë për mirëmbajtje të rrugëve ta evitonte këtë masë të dheut. Kjo ndodh më 25 janar dhe rruga ka qenë fizikisht e hapur. Por kësaj rruge i është kanosur rreziku i





shembjeve të mëdha të kodrës, prandaj duhej të merrej vendimi për hapjen e kësaj rruge, por nuk ishte lehtë, me fjalë të tjera kanë kaluar disa kompetenca në pjesën e sigurisë. Kam formuar grupet punuese prej nivelit më të lartë të menaxhimit të situatës deri të grupet teknike, grupet profesionale me të cilat janë marrë gjatë gjithë kohës. Në pajtim me sugjerimet e grupeve të punës merrja vendimet përkatëse, varësisht nga shembja e dheut. Shkak i shembjes ishte eksploatimi shumëvjeçar i keq i kodrës.

Kam pasur nuk e di a taksirat apo nder të ballafaqohet Ministria e Transportit me këtë punë, meqë realisht i tejkalon përgjegjësit e Ministrisë së Transportit.

Pyetja sa ka kushtuar kjo rrugë? Të gjitha punët që u kryen brenda 50 ditëve, kanë kushtuar 367 mijë euro, që kur i shtohet edhe kompensimi i dy pronave të pronarëve, të cilët atë pronë më nuk e shfrytëzojnë se është shembur, atëherë mbërrin 387 mijë euro.

Sa i përket Projektit të autostradës, Prishtinë – Durrës, përkatësisht Merdar – Prishtinë - Durrës, ai ka filluar në vitin 2004 dhe kontraktuesi gjerman, kompania gjermane BPI Kancel, ka pasur për detyrë që brenda 7 muajve ta ndërtojë këtë projekt. Në momentin kur kam ardhur unë, projekti është dashur të kryhej diku në mars. Unë jam zgjedhur ministër,

ju e dini më 3 dhjetor 2004. Më 7 dhjetor kam marrë detyrën dhe më është dashur të ballafaqohesha edhe me një projekt që nuk ka qenë. Në kontratën e nënshkruar ishte, sipas ekspertëve tanë, mjetet e destinuara për këtë kanë qenë të paguara diku 80 – 85%, kurse puna për projektin ka qenë e realizuar më pak se 40%, që është dashur të merrem pastaj me këto. Mungesa e studimit të fizibilitetit dhe paraqitja e të dhënave për ta ndërtuar një projekt ka munguar. Kompania konsulente në momentin e parë të marrjes së detyrës si ministër ka ofruar kërkesën që kjo rrugë ose ky projekt do të kushtojë 4 milionë e 905 mijë euro, kurse kontrata ka qenë e nënshkruar 2 milionë e 800 e 49 mijë, nëse nuk gaboj. Projekti pas konsultimeve ka përfunduar dhe ka qenë shumë transparent. Kushtoi diku 3 milionë e 175 mijë euro bashkë me 15% TVSH. Tash nuk e kam atë shumë të përcaktuar këtu, por kjo është vlera. Pse nuk është bërë transparent, kujtoj që është shumë projekt transparent, sepse më 27 tetor të vitit 2005, publikisht para presidentit Rugova, ka përfunduar projekti bazik i autostradës.

Është shpallur edhe fizibiliteti i korridorit të shtatë që quhet autostradë edhe i korridorit 6, d.m.th. rrugët Prishtinë – Hani i Elezit dhe Prishtinë- Pejë –Deçan, si rrugë e gjathtë. Unë mendoj që të lidhet me

korridorin 8, t'jua them të drejtën zakonisht punët duhet të kryhen sipas preferencave të Bankës Botërore dhe standardeve evropiane. Asnjë rrugë nuk mund të fillojë së ndërtuari pa u bërë arsyeshmëria ekonomike, pra fizibiliteti, te ne ka ndodhur një dukuri, d.m.th. kemi filluar ndërtimin e projektit pa e bërë fizibilitetin dhe ne kemi qenë të shtrënguar dhe të detyruar, nëse dëshirojmë që këtë projekt ta çojmë përpara, që ta shpallim projektin e fizibilitetit për ta ndërtuar e për ta kompletuar, dhe jemi në këtë fazë. Në fazën e parë për ndërtimin e autostradës nuk është paraparë që në trasenë e saj do të ketë tunel se do të ketë numër të madh urash, ju lutem në studimin tonë që është bërë brenda Ministrisë, ka qenë studimi i mangët, nuk janë paraparë tunelet, që tash në projektin e ndërtuar janë afro 5 km. tunel, janë paraparë afër 51 ura, ndërsa janë 105 ura dhe këto e kanë rritur koston.

Ministria e Transporteve, pra Qeveria ka arritur që autostradën Merdar-Prishtinë-Durrës ta fuste në mesin e 20 prioriteteve të rrugëve rajonale në kuadër të observatoriumit të transportit për shtetet e Evropës Juglindore, që njihet si SITO dhe në këtë kontekst është një fitore shumë e madhe, sepse kemi arritur ta përfshijmë si në prioritet edhe rikonstruimin e Aeroportit dhe mund të vjelim donacion, ndihmesë apo investime,

më mirë të them, 154 milionë euro për 5 vjetët e ardhshme dhe kjo është një sukses jo vetëm i Ministrisë dhe i tërë Qeverisë, por edhe i Kuvendit. Mendoj se Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, është një ndër ministritë që nuk kanë treguar aktivitet të mjaftueshëm. Kjo shihet nga gjendja e rrugëve magjistrale. Për shkak të këtij aktiviteti kemi humbur shumë iniciativa rajonale, edhe sa i përket Paktit të Stabilitetit në tryezën e dytë të infrastrukturës, ku kanë qenë të përfshira institucionet e Kosovës dhe Ministria, po edhe në programet e REBIS-it. Mendoj se një sëmundje e përgjithshme është çështja e marrjes ose fitimit të tenderëve. Kjo po reflektohet edhe më tutje në Ministrinë e Transportit e të Telekomunikacionit. Është koha që pas 6 ose 7 vjetëve të kemi një evidencë për kompanitë që kanë punuar më mirë, kanë bërë punë kualitative që t'ju jepet prioritet e jo të angazhohen kompanitë ose nënkontaktorët që edhe punën nuk e kanë cilësore dhe ende pa hyrë në stinorin e dimrit, për dy- tre muaj ato harrime që bëhen dëmtohen për arsye se as nuk kanë laborator për kontrollimin e asfaltit, pra as një parametër që garanton.

Alush Gashi tha se Grupi Parlamentar i LDK-së i jep mbështetje të plotë përgjegjëses së hartuar me shkrim dhe e mirëpresim përgjigjen e tij me gojë, si përgjigje të plotë. Si grup parlamentar ne angazhohemi për shtim të fondeve për mirëmbajtje, ndërtim dhe zhvillim të infrastrukturës rrugore në Kosovë dhe të rrugëve ndërkombëtare të Kosovës. Kërkojmë nga Ministria dhe Qeveria angazhime shtesë në argumentim të domosdosë së lidhjes së Kosovës me pjesën e Mediteranit, si edhe me rrugët të cilat do të shpien për Portin e Selanikut dhe për portet e tjera rajonale.

Nga Ministria kërkojmë të bëhen përpjekje shtesë, në promovim të domosdosë së ngritjes së fondeve,

mjetet e të cilave krijohen nga taksat dhe pagesat të cilat aktualisht bëhen për çështje të rrugëve të Kosovës dhe nuk derdhen në këtë fond. Andaj, duke përgëzuar ministrin e riafirmojmë qëndrimin tonë se Kosova si vend i vogël ka nevojë për përkujdesje shumë më të madhe për ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe për investim shumë më të theksuar për atë që nuk është sot çështje e bisedës, e që është zhvillimi i Aeroportit Ndërkombëtar të Kosovës në Prishtinë.

Fatmire Mulhaxha - Kollçaku tha se disa çështje nuk mund të presin, mbushja e një grope së paku përkohehësisht, do të shpëtonte shumë jetë, do të na mundësonte së paku ne deputetëve të vijmë të sigurt në Prishtinë. Ka edhe shumë probleme të tjera brenda qyteteve, por po ia lëmë komunës.

Naim Maloku tha se në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së e mirëpresim paraqitjen e z. ministër në interpelancë, duke shtuar në vijim se duhet të rishqyrtojmë vendimin e Parlamentit të Kosovës, që në Ligjin për rrugët, nuk kemi lejuar fond të veçantë nga taksat që merren nga qytetarët e Kosovës me rastin e regjistrimit të veturave dhe të ndahet një fond i veçantë. E kemi bërë në ligj që ajo taksë të derdhet në buxhetin e konsoliduar të Kosovës, pra, ne vetë kemi vendosur, si Kuvend, që Ministria të mos e manipulonte atë taksë dhe normalisht ka shkaktuar huti te qytetarët e Kosovës dhe të të gjithë pronarët e automjeteve që pyesin se ku janë ato mjete. Unë ftoj që të fillojë një procedurë se a është e arsyeshme të rishqyrtohet edhe një herë apo të plotësohet Ligji mbi rrugët dhe ky Kuvend të marrë vendimin që me ndryshimin e Ligjit të formohet një agjenci që do të merrej me mbledhjen e asaj takse dhe normalisht me planifikimin e ripërtëritjes apo me rehabilitimin e rrugëve, pra që taksa t'i dedikohet vetëm mirëmbajtjes së rrugëve.

Zef Morina theksoi se në bazë të fizibilitetit që është bërë nga

ekspertët e Drejtorisë së Rrugëve del që rruga Prishtinë – Durrës mund të kategorizohet ose të punohet si autostradë, pasi brenda 24 orëve nëpër të rrugë tani kalojnë më së 13 mijë e 500 automjete, kriteri i mjaftueshëm që rruga të kategorizohet ose të ndërtohet autostradë dhe pikërisht për këtë ne e kemi shpallur tenderin për ndërtimin e projektit zbatues, i cili ka qenë ndërkombëtar dhe kanë marrë pjesë 4 kompani. Është e vërtetë që kompania më e shtrenjtë ka qenë rreth 4 milion, ndërsa më e lira ka qenë rreth 2.5 milion €, pa llogaritur TVSH-në. Mua më intereson pas raportit që e kam lexuar, pse u ndryshua kontrata dhe u shtrenjtua 35% dhe çështja tjetër, pse nuk janë ndërtuar ose nuk janë projektuar projektet e veprave të artit?

Berat Luzha shtroi pyetjen pse nuk u bë asgjë për rehabilitimin e rrugës tjetër alternative, asaj që lidh Hanin e Elezit me Qafë Shqipen, e gjatë vetëm 10 km, e cila i shmanget Grykës së Kaçanikut.

Bajrush Xhemaili tha se tenderët iu jepen fantom firmave apo kompanive, sidomos atyre jashtë Kosovës që askush nuk e di që ekzistojnë, së paku në Kosovë nuk kanë kryer asnjë punë, as kur kanë konkurruar, as para se të konkurrojnë, as pasi që kanë konkurruar. Pikërisht këto firma që nuk ekzistojnë në Kosovë po i marrin tenderët më të rëndësishëm dhe prapëseprapë punët i kryejnë kompanitë vendore si nënkontaktor, ndaj dhe mund të kuptohet se si janë punimet. Për shembull, kompania IDG nga Italia e cila nuk e ka sjellë as një lopatë në Kosovë, ka marrë njërin nga tenderët më të rëndësishëm, më me peshë dhe me çmim mbi 3 milionë.

Ramadan Kelmendi tha se aksi rrugor Mitrovicë-Zveçan-Leposaviq, është i mbyllur për shqiptarë dhe andej mund të kalohet shumë rrallë. Pjesa perëndimore e rajonit të Shalës është e mbyllur. Është bërë përpjekje të bëhet një rrugë fshati e

cila do ta lidhte atë rajon duke filluar prej fshatrave Magjerë, Dedi, Bistricë dhe Cerajë. Do të ishte mirë të punohet në atë drejtim, sepse do t'i ndihmohej asaj popullate, që në rrethanat ekzistuese të ketë lidhje me qytetin e Mitrovicës. Është mbyllur edhe aksi rrugor që shpie në kompleksin e kullave të Isa Boletinit nga kisha ortodokse, në një mënyrë të njëanshme dhe pa pëlqimin, pa nënshkrimin e familjeve të Isa Buletinit. Ai kompleks nuk mund të funksionalizohet. Do të ishte mirë të gjithë ata që kanë ndikim dhe ne si organ më i lartë të bëjmë diçka në këtë drejtim, sepse po bëhen 15 muaj që varret e hapura rrinë dhe nuk bëhet rivarrimi i heroit tonë kombëtar Isa Buletini me luftëtarët e tij, edhe pse është kryer i tërë projekti, por fle ky projekt për një rrugë prej 2 kilometrash.

Gjergj Dedaj u shpreh se nëpër shumë rrugë në Kosovë tash e tutje mund të kalojmë vetëm me traktorë ose këmbë, për shkak të dëmeve evidente. Mendoj se për këtë duhet të jetë e shqetësuar dhe e preokupuar Ministria në fjalë dhe vetë ministri.

Xhavit Haliti përmendi faktin se deri tash janë miratuar tri ligje për rrugët. Ligji për rrugët që u miratua në nëntor të vitit 2003; Ligji për transportin rrugor që është miratuar në vitin 2004 dhe Ligji për transportin e mallrave të rrezikshme që është miratuar në vitin 2004, d.m.th nga mandatimi i Qeverisë aktuale nuk është miratuar dhe nuk është në procedurë të Kuvendit asnjë ligj tjetër. Pyetja e tij ishte: në cilën fazë është përgatitja e Ligjit për siguri në rrugë dhe a është duke u hartuar në përputhshmëri me Kartën e Unionit Evropian për sigurinë rrugore?

Për mirëmbajtje të rregullt verore të rrugëve nevojiten 14 milionë euro

Qemajl Ahmeti duke u përgjigjur në pyetjet shitesë zuri në gojë taksën që është marrë prej Valës 900 dhe është destinuar për projekte kapitale në

Njësinë e Transportit. Ajo taksë ka qenë në vlerë prej 6.9 milion euro, për atë shumë janë paraparë 9 projekte, prej atyre 9 projekteve 8 projekte kanë dalë në tender.

Në kërkesat e Ministrisë ka qenë edhe rruga Vushtrri-Skenderaj, por kjo nuk është shpallur në tender dhe nuk ka pasur mjete të ndara për këtë rrugë.

Duke folur rreth shtimit të fondeve ai theksoi se për mirëmbajtje të rregullt verore në bazë të studimeve, që i kemi të Ministrisë, të AER-it, të Bankës Botërore, në rrugët e Kosovës aty që është përgjegjës Ministria e që janë rrugët magjistrale dhe regjionale nevojiten 14 milion euro. Sot Ministria e Transportit, por edhe në vitin e kaluar për mirëmbajtje të rrugëve i ka 5 milion euro, 4 milion e gjysmë janë për mirëmbajtje verore, 500 mijë janë për mirëmbajtje dimërore. Tash mendoni: a ka mundësi që me 5 milion € të mirëmbahen 2000 km rrugë në nivelin çfarë dëshirojmë. Ndërkaq për rehabilitimin e rrugëve, ristrukturimin e atyre rrugëve magjistrale rajonale, për dhjetë vjetët e ardhshëm nevojiten 48 milion euro në vit. Prandaj, për këtë arsye, duke pasur parasysh këtë studim, unë kam propozuar, pra Ministria e Transportit ka propozuar disa herë që të themelojmë Fondin e rrugëve, i cili do të mbushej pastaj prej taksave të destinuara. Një prej taksave është taksa rrugore. Parimisht, në Qeveri është përkrahur një propozim i tillë, por për themelimin e fondeve ju e dini se është pengesë Ligji për menaxhimin publik të financave, prandaj kemi nisur në Qeveri që të bëjmë ndryshimin dhe amendamentimin e këtij ligji. Megjithatë nuk ka shkuar lehtë, sepse këtë nismë duhet ta marrë Këshilli Fiskal. Unë insistoj që të kemi një fond për ndërtimin e rrugëve enkas, ku do të grumbullohen mjete nga taksat e rrugëve edhe taksa të tjera.

Duke u ndërlidhur me diskutimin e deputetes Hatixhe Hoxha rreth projektit Zhegër-Stanqij-Kumanovë tha

se gjatë miratimit të buxhetit ky projekt është përkrahur nga Qeveria. Tash është në proces të tenderimit dhe besoj që këtë vit do të hapet.

Lidhur me pyetjen se a kalon korridori i 7-të, sipas projektit, nëpër basenin e linjtit, Ahmeti pohoi se lidhur me këtë bashkëpunohet me ministrinë përkatëse, përkatësisht: me Ministrinë e Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Minierave dhe atë të Mineraleve. Projekti nëpërmes basenit të Linjtit tash nuk kalon nëpër 50%, por kalon në një pjesë që marrë në tërësi prej projektit të parë është diku 2%, me fjalë tjera është larguar prej basenit.

Numri i automjeteve sillet diku prej 280.000 deri në 340.000 automjete. Nëse merret numri treqind mijë, nga 40 euro, del se diku 12 apo 13 milion euro mund të grumbullohen nga kjo taksë.

Jakup Krasniqi tha se gjendja në të gjitha rrugët e Kosovës është e keqe dhe mendoj që për këtë u fol shumë këtu. Ministria duhet të hartojë strategjinë e daljes nga kjo gjendje. Duhet të ketë një pasqyrë të tërësishme, një plan të detajuar afatshkurtër dhe afatmesëm, thënë ndryshe një plan emergjent për ta sanuar gjendjen e rrugëve në Kosovë, se përndryshe kështu po dëmtohet fuqia e Buxhetit të konsoliduar të Kosovës, por edhe e qytetarëve.

Në vijim Krasniqi shtroi kërkesën që të formohet së paku një komision hetimor për t'i gjetur se ku kanë mbetur 6.9 milion euro të Buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Qemajl Ahmeti lidhur me kërkesën e Jakup Kranqit sqaroi se mjetet me vlerë prej 6.9 milion euro, ndoshta e kam thënë kanë humbur, ndërkaq kam dashur të them ato mjete nuk kanë ardhur fare në Ministri dhe se janë shkrirë në buxhetin 2005, por kjo nuk ka të bëjë me humbje, por nuk kanë ardhur në buxhetin e Ministrisë së Transportit, prandaj kërkoj falje për keqinterpretim.

U bë ndarja e diplomave për 70 aktivistë të rinj nga subjektet politike shqiptare, serbe, turke dhe rome

Demokracia është proces që gjithnjë duhet vazhduar e begatuar, prandaj edhe institucioneve të reja demokratike të Kosovës ju duhen forca të reja, gjenerata të reja

Në ambientet e Kuvendit të Kosovës, sot u organizua ceremonia solemne e ndarjes së diplomave për 70 aktivistë të rinj nga subjektet politike shqiptare, serbe, turke dhe rome. Certifikatat u dhanë nga Akademia për Trajnim Partiak e organizuar nga Instituti Demokratik Kombëtar (NDI) në Kosovë. Në këtë solemnitet merrnin pjesë Kolë Berisha, kryetar i Kuvendit të Kosovës, Ken Yamashita, drejtor i Misionit të USAID-it për Kosovë, deputetë të Kuvendit të Kosovës, Ismet Beqiri, kryetar i Komunës së Prishtinës, si dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve të Kosovës.

Duke hapur këtë ceremoni Chad Rogers, drejtor i NDI-së, tha se partitë në Kosovë e kanë kuptuar qartas nevojën për të trajnuar dhe përfshirë një gjeneratë të re të organizatorëve dhe zyrtarëve të zgjedhur. Këta 70 të rinj janë nder për partitë e tyre dhe për Kosovën, për vetë përkushtimin që kanë treguar dhe punën që do ta bëjnë për të ndërtuar një shoqëri demokratike.

Duke përshëndetur pjesëmarrësit kryeparlamentari Berisha tha se sot ndihemi vërtet shumë mirë në ceremoninë e ndarjes së certifikatave, të cilat dëshmojnë për dijen tuaj teorike e praktike të fituar gjatë kursit katërmujor mbi mënyrën e funksionimit të Kuvendit të Kosovës, të kuvendeve komunale, mënyrave të organizimit të takimeve të zyrtarëve të zgjedhur me qytetarët, e të tjera.

Kursi u organizua nga USAID-i dhe nga NDI-ja, të cilat po ashtu, i falënderoj dhe i përgëzoj sinqerisht edhe për këtë projekt kaq kapital, krahas shumë projekteve të tjera po kaq kapitale në Kosovë.

E dimë se do të çmohemi e do të



mbahemi mend ndër breza për punën që kemi bërë dhe në bazë të rezultateve që kemi arritur, por, do të çmohemi dhe do të përkujtohemi, pothuajse në të njëjtën masë, dhe pikërisht në bazë të asaj se çfarë brezi dhe çfarë kualiteti do të përgatisim që të na zëvendësojë.

Prania juaj sot e këtu dëshmon se ne po mendojmë për të ardhmen, se ne, jo vetëm se duam, por edhe po e ndërtojmë të ardhmen. Në këtë aspekt, e them lirisht se ndjehem krenar që ju, një gjeneratë e re, nesër do të jeni pjesa prijëse e shumicës së subjekteve tona politike dhe institucionale të Kosovës.

Kjo ardhje juaja në këto hallka të sistemit do të sjellë freski e përvoja të reja që do ta shtojnë dinamikën brenda partive tuaja, pastaj garën mes subjekteve politike me qëllim të pasurimit të ofertës në interes të Kosovës dhe të qytetarëve të saj.

Ofertë në këtë rast është çdo projekt që paraqet zgjidhje sa më efikase e sa më funksionale për çdo gjë që i intereson qytetarit. Dhe, vetëm pasi të keni menduar mirë dhe pasi të gjeni projektin më efikas, ju do të kërkonit votën dhe besimin e qytetarëve në këmbim për punën tuaj të palodhshme, për ndihmë dhe përgjegjësi të vazhdueshme.

Këto ditë ju keni mësuar shumë nga

këto gjëra të cilat do t'i zbatoni sipas rregullave të qarta e të forta të lojës demokratike.

Jam i sigurt se keni mësuar edhe diçka që është edhe më e rëndësishme se ky mësim: keni kuptuar rëndësinë dhe magjinë e mësimimit. Mendoni sa gjëra nuk i keni ditur para së të filloni këtë kurs. Mendoni sa më të pasur e sa më të sigurt në vetvete jeni sot dhe sa më mirë do të ndiheni në të ardhmen nëse vazhdoni të mësoni edhe më tutje.

Pikërisht nga këto ambiente të Kuvendit dua t'ua bëj një thirrje - sfidë, secilit prej jush: që sot, që nga ky moment, mendoni për atë çast të ardhjes suaj në Kuvendin e Kosovës, si deputetë e përfaqësues të zgjedhur të popullit. Mendoni se pikërisht ju do të konkurrioni dhe dotë fitoni votat në zgjedhjet e vitit 2007 dhe mendoni se çfarë ndryshimesh pozitive, çfarë ndihmese mund të bëni ju për komunitetin, për Kosovën. Kuvendi, institucionet e Kosovës, kanë nevojë për ju, kanë nevojë për ide, për përvoja dhe qasje të reja.

Më lejoni t'ua jap vetëm një këshillë, të cilën edhe mua ma kanë thënë në rininë time: nisuni në këtë rrugë me vullnet të mirë, me dashuri për Kosovën dhe për njerëzit e saj, sepse këtë mund ta bëj secili prej jush. Mos u besoni atyre që thonë se nuk ka ose nuk duhet të ketë moral në politikë. Në jetë, më shumë së çfarëdo tjetër, duhet të ketë moral.

E, politika është pjesë e jetës, theksoi Kolë Berisha.

Të certifikuarit e rinj i përgëzoj edhe Ken Yamashita, duke theksuar se ndihet i lumtur që sheh një grup të të aktivistëve të rinj të partive të ndryshme, sepse kjo është një shenjë që tregon se partitë politike janë duke menduar për të ardhmen.



Ceremonia solemne e ndarjes së diplomave nga ana e NDI-së